



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2014 – Numri: 137

Tiranë – E Hënë, 1 Shtator 2014

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 97/2014 datë 24.7.2014	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8136, datë 31.7.1996, “Për Shkollën e Magjistraturës”, të ndryshuar..... 6279
Ligj nr. 100/2014 datë 31.7.2014	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”..... 6282
Ligj nr. 101/2014 datë 31.7.2014	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8811, datë 17.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, të ndryshuar..... 6285
Ligj nr. 103/2014 datë 31.7.2014	Për miratimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë..... 6287
Ligj nr. 104/2014 datë 31.7.2014	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar..... 6304
Ligj nr. 107/2014 datë 31.7.2014	Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit..... 6315
Ligj nr. 108/2014 datë 31.7.2014	Për Policinë e Shtetit..... 6336
Ligj nr. 115/2014 datë 31.7.2014	Për ndarjen administrativo-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë..... 6365
Vendim i Kuvendit nr. 56/2014 datë 1.9.2014	Për rrëzimin e dekretit nr. 8675, datë 11.8.2014, të Presidentit të Republikës, “Për kthimin për rishqyrtim të ligjit nr. 97/2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8136, datë 31.7.1996, “Për Shkollën e Magjistraturës”, të ndryshuar”..... 6391
Vendim i Kuvendit nr. 57/2014 datë 1.9.2014	Për rrëzimin e dekretit nr. 8678, datë 15.8.2014, të Presidentit të Republikës, “Për kthimin për rishqyrtim të ligjit nr. 100/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative””..... 6391

Vendim i Kuvendit nr. 58/2014 datë 1.9.2014	Për rrëzimin e dekretit nr. 8679, datë 15.8.2014, të Presidentit të Republikës, “Për kthimin për rishqyrtim të ligjit nr. 101/2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8811, datë 17.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, të ndryshuar”.....	6391
Vendim i Kuvendit nr. 59/2014 datë 1.9.2014	Për rrëzimin e dekretit nr. 8681, datë 15.8.2014, të Presidentit të Republikës, “Për kthimin për rishqyrtim të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit””.....	6392
Vendim i Kuvendit nr. 60/2014 datë 1.9.2014	Për rrëzimin e dekretit nr. 8696, datë 22.8.2014, të Presidentit të Republikës, “Për kthimin për rishqyrtim të ligjit nr. 115/2014, “Për ndarjen administrativo-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë””.....	6392
Vendim i Kuvendit nr. 61/2014 datë 1.9.2014	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për shkarkimin e Ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin.....	6392
Vendim i Kuvendit nr. 62/2014 datë 1.9.2014	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërimin e Ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin.....	6392



**LIGJ**  
**Nr. 97/2014**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË**  
**LIGJIN NR. 8136, DATË 31.7.1996, “PËR**  
**SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS”,**  
**TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 8136, datë 31.7.1996, “Për Shkollën e Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

**Neni 1**

Në nenin 6 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Shkronjat “ç”, “e” dhe “f”, të paragrafit të parë, ndryshohen si më poshtë:

ç) Një gjyqtar dhe një prokuror me përvojë, që caktohen përkatësisht nga Konferenca Kombëtare Gjyqësore dhe nga Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve. Anëtari i zgjedhur nga Konferenca Kombëtare Gjyqësore nuk mund të jetë njëkohësisht anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe anëtar i zgjedhur nga Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve nuk mund të jetë njëkohësisht anëtar i Këshillit të Prokurorisë;

e) Një përfaqësues i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, që caktohet nga radhët e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Titujve Akademikë me përvojë të spikatur në fushën juridike;

f) Përgjegjësit e trajnimit fillestar dhe vazhdues, si dhe dy pedagogë të brendshëm të Shkollës së Magjistraturës;”.

2. Shkronjat “b” dhe “e”, të paragrafit të dytë, ndryshohen si më poshtë:

“b) Merr masa për zbatimin e rregullave të përzgjedhjes së trupës mësimdhënëse, si dhe bën emërimin dhe largimin e tyre nga detyra, me propozimin e shumicës së anëtarëve të Këshillit Drejtues ose të Drejtorit të Shkollës;

“e) Paraqet raporte vjetore përpara Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrisë të Drejtësisë për rezultatet e arritura dhe drejtimit e punës për të ardhmen.”.

3. Pas paragrafit të tretë shtohet një paragraf i katërt me këtë përmbajtje:

“Votimet që kanë të bëjnë me persona, drejtues, pedagogë etj. kryhen me votim të fshehtë, mbështetur në ligjin për vendimmarrjen e organeve kolegjiale.”.

**Neni 2**

Neni 7 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 7

Drejtor i Shkollës së Magjistraturës mund të emërohet shtetasi shqiptar që në momentin e kandidimit përmbush së bashku këto kushte ligjore:

a) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;

b) të ketë punuar si gjyqtar ose prokuror për jo më pak se 10 vjet ose si jurist me jo më pak se 15 vjet përvojë profesionale;

c) të ketë jo më pak se 10 vjet mësimdhënie në Shkollën e Magjistraturës nga marrja e gradës shkencore “Doktor” ose jo më pak se 5 vjet mësimdhënie në Shkollën e Magjistraturës nga marrja e titullit shkencor “Profesor” ose jo më pak se 15 vjet mësimdhënie si pedagog i brendshëm apo pedagog i jashtëm në Shkollën e Magjistraturës;

ç) të mos jetë i dënuar penalisht me vendim të formës së prerë;

d) të mos ketë kryer gjatë 10 viteve të fundit asnjë funksion apo veprimtari me natyrë politike.”.

**Neni 3**

Pas nenit 7 shtohet neni 7/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 7/1

Drejtori i Shkollës së Magjistraturës emërohet nga Këshilli Drejtues i Shkollës, me konkurrim, mbi bazën e dokumentacionit, për një mandat 4-vjeçar me të drejtë riemërimi vetëm një herë.

Në rastet kur Drejtori i Shkollës së Magjistraturës përzgjidhet nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve që plotësojnë kushtin e shkronjës b, të nenit 7, të këtij ligji, emërimi i tyre bëhet vetëm pasi të jetë dhënë pëlqimi, përkatësisht, nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë ose Prokurori i Përgjithshëm, sipas kërkesës së Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës.

Gjatë kohës së qëndrimit në funksion, Drejtori i Shkollës së Magjistraturës gëzon statusin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.



Funksioni i Drejtorit të Shkollës së Magjistraturës është i papajtuashëm me çdo funksion tjetër publik, anëtarësimin në partitë politike apo pjesëmarrjen në veprimtaritë e tyre, ose kryerjen e çdo veprimtarie tjetër fitimprurëse, me përjashtim të mësimdhënies.

Periudha e ushtrimit të funksionit të Drejtorit të Shkollës së Magjistraturës njihet si periudhë vjetërsie në punë, si gjyqtar a prokuror, për efekt të kërkesave të karrierës profesionale, të parashikuara në dispozitat ligjore për organizimin e pushtetit gjyqësor, Gjykatën e Lartë, Gjykatën Kushtetuese dhe Prokurorinë.

Gjyqtarët a prokurorët, që shërbejnë në funksionin e Drejtorit të Shkollës së Magjistraturës, me kërkesë të tyre, rikthehen në vendet e punës që u ruhen nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë apo Prokuroria e Përgjithshme.”

Neni 4

Neni 8 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 8

Drejtori i Shkollës së Magjistraturës ka këto detyra:

a) Përfaqëson Shkollën e Magjistraturës në marrëdhënie me të tretët;

b) Harton dhe propozon në bashkëpunim me Këshillin Pedagogjik, projektin e Rregullores së Brendshme të Shkollës, projekt-programin vjetor të veprimtarive të saj, si dhe ndryshimin e tyre;

c) Zbaton detyrat që burojnë nga ligjet dhe nga vendimet e Këshillit Drejtues dhe bashkëpunon me institucionet, të cilave iu raporton sipas këtij ligji;

ç) Kërkon fonde nga shteti, donacione nga burime të tjera të ligjshme dhe administron në mënyrë të pavarur të ardhurat, sipas drejtimeve kryesore të përcaktuara nga Këshilli Drejtues, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 4;

d) Merr masa për publikimin e literaturës dhe të teksteve;

dh) Drejton trupin pedagogjik, bashkërendon punën me ta, kërkon dhe miraton programet mësimore të çdo lënde dhe kontrollon zbatimin e tyre dhe cilësinë e mësimdhënies, i propozon Këshillit Drejtues kandidatët për pedagogë të jashtëm, sipas kriterëve të caktuar në këtë ligj;

e) Në bashkëpunim me Këshillin Pedagogjik, i propozon Këshillit Drejtues, emërimin, lirimin ose shkarkimin nga detyra të personelit mësimdhënës dhe kancelarit. Lirimi nga detyra i personelit të brendshëm dhe të jashtëm mësimdhënës bëhet vetëm pasi të jenë paraqitur arsyet dhe të merret mendimi edhe i Këshillit

Pedagogjik të Shkollës. Vlerësimi i kandidatëve për magistratë për stafin mësimdhënës e shoqëron këtë proces. Nëse edhe Këshilli Pedagogjik jep mendim të favorshëm për lirimin nga detyra, atëherë drejtori i përcjell Këshillit Drejtues propozimin për vendimmarrje.

ë) Emëron, liron ose shkarkon punonjësit e personelit administrativ të Shkollës, marrëdhëniet e punës së të cilëve rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës;

f) Nën autoritetin e tij, kancelari i shkollës realizon veprimtarinë financiaro-administrative të institucionit.”

Neni 5

Pas nenit 8 shtohet neni 8/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 8/1

Drejtori i Shkollës së Magjistraturës lirohet nga detyra kur:

a) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;

b) nuk paraqitet në detyrë për më shumë se 3 muaj;

c) jep dorëheqjen;

Drejtori i Shkollës së Magjistraturës mund të shkarkohet nga Këshilli Drejtues i Shkollës kur:

a) deklarohet i paafte mendor ose fizik nga organi përkatës shtetëror,

b) kryen akte ose sjellje, që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e tij dhe atë të Shkollës së Magjistraturës,

c) për pamjaftueshmëri profesionale, në rast të mospërmbushjes së kriterëve të caktuar nga ky ligj;

ç) në rastet e moszbatimit të vendimeve të Këshillit Drejtues të Shkollës;

d) kryen veprimtari që krijojnë konflikt interesash;

dh) për shkelje të dispozitave të këtij ligji.”

Neni 6

Në nenin 9, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Detyrat dhe rregullat për funksionimin e Këshillit Pedagogjik janë:

a) merr pjesë në përgatitjen e planit mësimor të Formimit Fillestar dhe të Programit të Formimit Vazhdues;

b) jep mendim për hartimin e listës së trajnerëve të jashtëm dhe të brendshëm të shkollës, duke analizuar çdo propozim që drejtori do t'ia përcjellë Këshillit Drejtues;



c) analizon raportet e vlerësimit të punës së trajnerëve dhe pedagogëve ekzistues nga kandidatët për magistratë dhe stafi mësimdhënës dhe i përcjell Këshillit Drejtues mendimin e tij për vijimësinë e ushtrimit të detyrës prej tyre;

ç) merr pjesë, në përputhje me këtë ligj, në shqyrtimin e procesit disiplinor të iniciuar ndaj stafit mësimdhënës;

d) miraton, për t'ia përcjellë Këshillit Drejtues si propozim, emrat e lektorëve, pedagogëve dhe trajnerëve të rinj që i shtohen stafit akademik të Shkollës së Magistraturës;

dh) shqyrton dhe miraton rekomandimet e asamblesë së kandidatëve për cikle speciale leksionesh në fusha specifike të së drejtës, etikës, sociologjisë dhe psikologjisë juridike, si dhe përpunon orientime për veprimtarinë praktike të kandidatëve gjatë stazhit paraprofesional dhe profesional;

e) bën vlerësimin përfundimtar të kandidatëve të Formimit Fillestar, mbi bazën e rezultateve të arritura gjatë periudhës dyvjeçare të vitit teorik dhe stazhit paraprofesional dhe në përfundim të stazhit profesional.

ë) ndjek në vazhdimësi zbatimin e vendimeve të Këshillit Drejtues në veprimtarinë akademike të shkollës.”

Neni 7

Në nenin 12, pika 7 ndryshohet si më poshtë:

“7. Rregullat e hollësishme për procedimin disiplinor të kandidatëve për magistratë caktohen nga Këshilli Drejtues i shkollës.

Neni 8

Neni 15 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 15

1. Pedagogët e brendshëm dhe të jashtëm emërohen nga Këshilli Drejtues me propozim të drejtorit ose çdo anëtari të Këshillit Drejtues.

2. Pedagogët e brendshëm zgjidhen nga radhët e juristëve më të shquar me eksperiencë mbi 15-vjeçare si juristë, gjyqtarë, prokurorë, avokatë dhe me eksperiencë mësimdhënëse universitare apo në Shkollën e Magistraturës mbi 10 vjet.

3. Për lëndët kryesore mund të aktivizohen edhe pedagogë të jashtëm, të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, për pedagogët e brendshëm. Nëse kandidati për pedagog i jashtëm vjen nga radhët e gjyqtarëve ose prokurorëve në detyrë, të cilët kanë përfunduar Shkollën e Magistraturës, duhet të

plotësojnë kriteret e të qenit 10 vjet gjyqtar ose prokuror dhe me eksperiencë mësimdhënëse universitare apo në Shkollën e Magistraturës mbi 5 vjet. Për lëndët specifike aktivizohen specialistë të atyre fushave.

4. Pedagogët, për lëndët që zhvillojnë vetë, duhet të ndjekin edhe kurset dhe seminarët për trajnimin e trajnerëve që zhvillohen periodikisht nga shkolla apo institucione të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare.

5. Përgjegjësit e trajnimit fillestar dhe vazhdues zgjidhen nga Këshilli Drejtues nga radhët e pedagogëve të brendshëm të shkollës.”

Neni 9

Pas nenit 15 shtohet neni 15/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 15/1

1. Pranimi dhe emërimi i gjyqtarëve a prokurorëve si pedagogë të brendshëm kryhet duke konkurruar sipas kriterëve të këtij ligji, si dhe pasi të jetë dhënë pëlqimi, përkatësisht, nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë ose Prokurori i Përgjithshëm, sipas kërkesës dhe propozimeve të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magistraturës.

2. Pedagogët e brendshëm gëzojnë statusin e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit, Tiranë; kancelari barazohet me Kancelarin e Gjykatës së Apelit, Tiranë.

3. Periudha e ushtrimit të funksioneve të përmendura në pikën 1 të këtij neni njihet si periudhë vjetërsie në punë, si gjyqtar a prokuror, për efekt të kërkesave të karrierës profesionale, të parashikuara në dispozitat ligjore për organizimin e pushtetit gjyqësor, Gjykatën e Lartë, Gjykatën Kushtetuese dhe Prokurorinë.

4. Gjyqtari ose prokurori qëndron në detyrë si pedagog i brendshëm për një periudhë 4-vjeçare, përveç rasteve kur jep dorëheqjen, ose shkarkohet nga organi përkatës.

5. Gjyqtarët a prokurorët, që shërbejnë në funksionin e pedagogut të brendshëm të Shkollës së Magistraturës, me kërkesë të tyre, rikthehen në vendet e punës që u ruhen nga KLD-ja apo Prokuroria e Përgjithshme.”

Neni 10

Neni 17 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 17

Kandidatët i nënshtrohen konkursit, i cili zhvillohet me shkrim dhe nën monitorim, i organizuar me dy faza,



nga të cilat e para me natyre kualifikuese dhe me vlerësim elektronik, aspektet teknike të të cilit përcaktohen në rregulloren e shkollës.

Kandidatët që kualifikohen në fazën e parë duhet të kalojnë në një testim të lidhur me shëndetin mendor dhe psikologjik, të kryer nga një komision i ngritur nga Këshilli Drejtues i Shkollës së Magistraturës në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë. Ky komision, aspektet teknike të të cilit përcaktohen në rregulloren e shkollës, përbëhet nga dy mjekë psikiatër, dy psikologë dhe një pedagog i brendshëm i Shkollës së Magistraturës.

Pas kalimit të këtij testimi, kandidatët pajisen me një leje aftësie për ushtrimin e profesionit të gjyqtarit apo prokurorit dhe futen në fazën e dytë të konkurrimit, që zhvillohet me shkrim para një komisioni të përbërë prej 5-7 vetash, të caktuar nga Këshilli Drejtues, nga të cilët 2-3 pedagogë të brendshëm dhe 3-4 pedagogë të jashtëm me eksperiencë mësimdhënëse në Shkollën e Magistraturës mbi pesë vjet. Këta të fundit nuk mund të jenë dy herë në mënyrë të njëpasnjëshme anëtarë komisioni.

Në përfundim të konkurrimit nxirret lista e fituesve, e cila miratohet nga Këshilli Drejtues. Kandidatët e pranuar janë të detyruar të frekuentojnë rregullisht programin dhe të respektojnë rregulloren e shkollës.”

Neni 11

Në nenin 23, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Programi i formimit vazhdues hartohet nga Drejtori i Shkollës në bashkëpunim me stafin e brendshëm pedagogjik pasi të jetë marrë, paraprakisht, mendimi i Kryetarit të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Ministrisë së Drejtësisë, Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Këshillit Pedagogjik të Shkollës. Programi i formimit vazhdues miratohet nga Këshilli Drejtues i Shkollës.”

Neni 12

### Dispozitë kalimtare

1. Anëtarët e Këshillit Drejtues, që parashikohen në nenin 6 pika 1, shkronjat “ç”, “d”, “e”, “ë”, “f”, “g” të ligjit, qëndrojnë në detyrë deri në datën 1 shtator 2014.

2. Brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Konferenca Gjyqësore Kombëtare, Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Asambleja e Kandidatëve për Magistratë që ndjekin Formimin Fillestar, duhet të zgjedhin anëtarët e rinj të Këshillit

Drejtues që do të plotësojnë vendet vakante që krijohen për efekt të këtij ligji.

3. Brenda 5 ditëve nga plotësimi i vendeve vakante, sipas pikës 2, të këtij neni, thirret mbledhja e Këshillit të ri Drejtues, për zgjedhjen e anëtarëve të rinj të Këshillit Drejtues, sipas nenit 6, pika 1, shkronja “P”, të ligjit.

4. Menjëherë pas konstituimit të Këshillit të ri Drejtues, sipas pikës 3, të këtij neni, ai verifikon plotësimin e kushteve dhe kriterëve nga drejtori, pedagogët e brendshëm dhe të jashtëm të shkollës.

5. Drejtori, pedagogët e brendshëm dhe të jashtëm të Shkollës së Magistraturës qëndrojnë në detyrë deri në zëvendësimin e tyre nga Këshilli i ri Drejtues, në rast se nuk plotësojnë kushtet dhe kriteret e parashikuara në ligj.

6. Viti akademik 2014 - 2015 fillon në datë 1 nëntor 2014.

7. Konkursi i pranimit për formimin fillestar në Shkollën e Magistraturës për vitin akademik 2014 - 2015 nuk do të zhvillohet. Konkursi i radhës do të zhvillohet për vitin akademik 2015 - 2016.

Neni 13

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Ilir Meta

Miraturuar në datën 24.7.2014

### LIGJ Nr. 100/2014

### PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR. 49/2012, “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E GJYKATAVE ADMINISTRATIVE DHE GJYKIMIN E MOSMARRËVESHJEVE ADMINISTRATIVE”

Në mbështetje të neneve 81, pika 2, shkronja “a”, 83, pika 1, dhe 135, pika 2, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:



## Neni 1

Në nenin 6 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Pika 3 riformulohet si më poshtë:

“3. Numri i ndihmësve ligjorë për çdo gjykatë administrative caktohet nga Ministri i Drejtësisë, në varësi të ngarkesës së punës për çdo gjykatë. Në çdo rast, numri i tyre nuk mund të jetë më i vogël se 50 për qind e numrit të gjyqtarëve të kësaj gjykate. Gjyqtari i gjykatës administrative ka deri në dy ndihmës ligjorë.”.

2. Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Procesi i përzgjedhjes së ndihmësit ligjor i nënshtrohet një procedure konkurruese rekrutimi, transparente dhe merite, sipas parashikimeve të këtij ligji.”.

## Neni 2

Pas nenit 6 shtohen nenet 6/1, 6/2, 6/3, 6/4 dhe 6/5 me këtë përmbajtje:

## “Neni 6/1

**Emërimi, lirimi dhe shkarkimi nga detyra**

1. Ndihmësi ligjor emërohet, lirohet apo shkarkohet nga detyra me urdhër të kryetarit të gjykatës, me propozimin e kancelarit gjykatës.

Kancelari i gjykatës përzgjedh dhe propozon për emërim ndihmësin ligjor nga lista e kandidatëve fitues, e shpallur nga komisioni *ad hoc*, sipas parashikimeve të nenit 6/4, të këtij ligji.

2. Propozohen dhe emërohen pa iu nënshtruar procedurave të konkurrimit kandidatët për ndihmës ligjorë, të cilët:

a) kanë përfunduar studimet në Shkollën e Magistraturës;

b) kanë punuar si gjyqtarë dhe nuk janë larguar nga sistemi për shkak të ndonjë mase disiplinore;

c) kanë punuar si këshilltarë të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, me përvojë pune në këto pozicione jo më pak se 5 vjet.

3. Propozimi i kancelarit të gjykatës për lirimin dhe shkarkimin nga detyra të ndihmësit ligjor shoqërohet me mendimin me shkrim të gjyqtarit përkatës, pranë të cilit ai ushtron detyrën.

4. Ndihmësi ligjor shkarkohet nga detyra për:

a) kryerjen e një vepre penale;

b) paaftësi mendore a fizike;

c) akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën, figurën e tij, imazhin e sistemit gjyqësor dhe besimin e publikut në sistemin gjyqësor;

ç) pamjaftueshmëri profesionale;

d) mospërbushje të detyrave të ngarkuara në mënyrë të përsëritur;

dh) mosrespektim në mënyrë të përsëritur të afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja të rënda;

e) moszbatim haptazi të dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale;

ë) braktisje të punës ose mungesë në mënyrë të pajustificuar dhe të vijueshme për 7 (shtatë) ditë pune ose më shumë, kur mungesa ka sjellë pasoja shumë të rënda në përmbushjen e detyrave të institucionit;

f) përfitim në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrës;

g) shkelje në mënyrë të përsëritur të rregullave të etikës.

5. Kur shkarkimi nga detyra është bërë në shkelje të parashikimeve të këtij ligji, ndihmësi ligjor ka të drejtën e ankimit në gjykatën administrative të rrethit gjyqësor më të afërt dhe të shpërbllimit të dëmit deri në shumën e pagës vjetore.

## Neni 6/2

**Paga e ndihmësit ligjor**

1. Ndihmësi ligjor që ushtron veprimtarinë e tij pranë gjykatës së shkallës së parë përfiton përkatësisht pagën në vlerën 75 për qind të pagës së gjyqtarit të kësaj gjykate. Pas 5 vitesh vjetërsie në këtë detyrë, për çdo vit vjetërsi, kjo pagë, deri në 25 vjet shërbim, shtohet me 2 për qind në vit, por jo më shumë se paga e gjyqtarit të kësaj gjykate.

2. Ndihmësi ligjor që ushtron veprimtarinë e tij pranë gjykatës së apelit përfiton përkatësisht pagën në vlerën 75 për qind të pagës së gjyqtarit të kësaj gjykate. Pas 5 vitesh vjetërsie në këtë detyrë, për çdo vit vjetërsi, kjo pagë, deri në 25 vjet shërbim, shtohet me 2 për qind në vit, por jo më shumë se paga e gjyqtarit të kësaj gjykate.

## Neni 6/3

**Kushtet për emërim**

Ndihmës ligjor mund të zgjidhet shtetasi shqiptar, që përmbush këto kushte:

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;

c) të jetë diplomuar si “Jurist”, sipas legjislacionit për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë në një nga fakultetet e drejtësisë, publike apo jopublike, të akredituara, brenda ose jashtë vendit;



c) të ketë përvojë profesionale si jurist në organet e sistemit të drejtësisë, në funksione publike në administratën e Kuvendit, administratën e institucionit të Presidentit, aparatit të Këshillit të Ministrave, ministri dhe institucione qendrore të pavarura, në Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën e Lartë, në Prokurori, si avokat apo si personel akademik i Fakultetit të Drejtësisë, të Universitetit të Tiranës, si më poshtë:

i) mbi 5 vjet përvojë pune për pozicionin e ndihmësit ligjor në gjykatën e shkallës së parë;

ii) mbi 7 vjet përvojë pune për pozicionin e ndihmësit ligjor në gjykatën e apelit;

d) të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

dh) të mos jetë i dënuar penalisht me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

e) të zotërojë të paktën një nga gjuhët zyrtare të Bashkimit Europian.

Neni 6/4

#### Shpallja e vendit vakant

1. Kryetari i gjykatës i komunikon strukturës përgjegjëse për administratën e gjyqësorit në Ministrinë e Drejtësisë vendet e lira për pozicionin e ndihmësit ligjor në gjykatë, të cilat duhet të shpallen për konkurs të hapur.

2. Struktura përgjegjëse për administratën gjyqësore në Ministrinë e Drejtësisë, jo më vonë se 15 ditë nga data e marrjes së njoftimit për vendet vakante, shpall datën e konkurrimit të hapur në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.

3. Ministri i Drejtësisë përcakton kriteret dhe procedurat e organizimit të testimit.

4. Kandidatët e interesuar për t'u emëruar ndihmës ligjorë paraqesin kërkesën pranë komisionit *ad hoc*, sipas njoftimit të shpallur për vendin vakant.

5. Komisioni *ad hoc*, pasi shqyrton të gjitha kërkesat, verifikon përmbushjen e kriterëve ligjorë, të parashikuara nga neni 6/3, i këtij ligji, për të vijuar procesin e testimit dhe shpall listën e konkurrentëve për pjesëmarrjen në konkurrim.

6. Komisioni *ad hoc* organizon dhe zhvillon testimin seleksionues dhe në përfundim të tij publikon rezultatet, në përputhje me rregullat e përcaktuara sipas pikës 3 të këtij neni.

7. Konsiderohen që kanë kaluar me sukses testimin seleksionues kandidatët që marrin jo më pak se 70 për qind të totalit të pikëve.

8. Komisioni *ad hoc* rendit në mënyrë përfundimtare kandidatët fitues, sipas numrit të

pikëve të marra, dhe listën ia dërgon gjykatës përkatëse. Lista nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit.

9. Në rast se numri i kandidatëve fitues, sipas këtij neni, është më i madh se numri i vendeve të lira të shpallura, të dhënat për kandidatët e tjerë mbahen në një listë pritjeje, pa qenë e nevojshme kryerja e një testimi tjetër seleksionues, në rastet e krijimit të një vendi vakant. Lista e pritjes vlen për një periudhë jo më të gjatë se 2 vjet.

Neni 6/5

#### Komisioni *ad hoc*

1. Komisioni *ad hoc* ka në përbërje:

a) kryetarit e gjykatës ku janë shpallur vendet vakante;

b) një gjyqtar të asaj gjykate;

c) kancelarin e asaj gjykate;

ç) një përfaqësues të strukturës përgjegjëse për administratën gjyqësore në Ministrinë e Drejtësisë;

d) një pedagog të së drejtës administrative në institucionet e arsimit të lartë me gradë shkencore jo më të ulët se “Doktor”;

dh) dy pedagogë të Shkollës së Magjistraturës.

2. Rregulla më të hollësishme për organizimin dhe funksionimin e komisionit *ad hoc* përcaktohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.

3. Anëtari i komisionit *ad hoc*, i përcaktuar në shkronjat “d” dhe “dh”, të pikës 1, të këtij neni, përfiton shpërblim për pjesëmarrje, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 3

Në nenin 12, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë gjykon në dhomë këshillimi me 3 gjyqtarë të gjitha çështjet që në gjykatën e shkallës së parë gjykohen nga 1 gjyqtar, si dhe çështjet që kanë për objekt mosmarrëveshjet e kompetencave. Çështjet e tjera gjykohen me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë.”.

Neni 4

Në nenin 49, pika 2, pas fjalëve “Sekretaria e gjykatës njofton palët rregullisht” shtohen fjalët “sipas rregullave procedurale në gjykimin civil në Gjykatën e Lartë”.

Neni 5

Neni 52 ndryshohet si më poshtë:





“Neni 52

### Njoftimi për gjykim në apelin administrativ

Njoftimi për gjykimin në apelin administrativ bëhet sipas rregullave procedurale që zbatohen në gjykimin civil në Gjykatë të Apelit.”.

Neni 6

Në nenin 61, pika 2, hiqen fjalët “sipas rregullave të përcaktuara për gjykimin në shkallë të parë dhe”.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Ilir Meta

Miratuar në datën 31.7.2014

## LIGJ Nr. 101/2014

### PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8811, DATË 17.5.2001, “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

## KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8811, datë 18.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Neni 5 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 5

Funksioni i anëtarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë është i papajtuashëm me:

a) funksionin e prokurorit ose me veprimtarinë e avokatisë në gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit;

b) ushtrimin e funksionit në kushtet e mosrespektimit të kufizimeve të vendosura nga legjislacioni në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit;

c) anëtarësinë, veprimtarinë ose ushtrimin e funksioneve në partitë politike;

ç) funksionin politik në administratën shtetërore.”.

Neni 2

Në nenin 6, pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të zgjedhur nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare, nuk mund të transferohen ose të ngrihen në detyrë gjatë ushtrimit të mandatit të tyre, si dhe një vit pas mbarimit të këtij mandati. Edhe në rast se anëtari Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i zgjedhur nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare, jep dorëheqjen përpara mbarimit të afatit 5-vjeçar, ai nuk mund të transferohet apo të ngrihet në detyrë deri në përfundim të periudhës së përcaktuar në këtë pikë.”.

Neni 3

Në nenin 7 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1 shfuqizohet shkronja “ë”.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Mbarimi i mandatit para afatit, në rastet e përcaktuara në shkronjat “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh”, “e”, deklarohet me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.”.

Neni 4

Pas nenit 7 shtohet neni 7/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 7/1

### Shkarkimi i anëtarit

Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë shkarkohet, përkatësisht, nga Konferenca Kombëtare Gjyqësore ose Kuvendi në këto raste:

a) për shkelje të Kushtetutës dhe të ligjit;

b) për kryerjen e një krimi;

c) për paaftësi mendore a fizike;

ç) për akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e tij;

d) vërtetohet njëra nga papajtueshmëritë e parashikuara në ligj.”.

Neni 5

Neni 9 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 9

Në mbledhjen e tij më të afërt, Këshilli i Lartë i Drejtësisë zgjedh një komision të përbërë nga 3 (tre) anëtarë të dalë prej tij, për të verifikuar rastet e



mbarimit para kohe të mandatit të anëtarit, sipas parashikimeve të nenit 7 të këtij ligji.”

#### Neni 6

Neni 10 ndryshohet si më poshtë:

#### “Neni 10

1. Raporti i Komisionit të Verifikimit të Mandateve duhet të përmbajë provat dhe argumentet ligjore për mbarimin ose jo para kohe të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Në përfundim të raportit, Komisioni i Verifikimit të Mandateve i paraqet Këshillit të Lartë të Drejtësisë propozimin përkatës.

2. Kur Këshilli i Lartë i Drejtësisë çmon se ekzistojnë rastet e parashikuara në nenin 7, të këtij ligji, me vendim të arsyetuar deklaron mbarimin para afatit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe i kërkon sipas rastit, Konferencës Gjyqësore Kombëtare ose Kuvendit të Shqipërisë zhvillimin e zgjedhjeve të reja.”

#### Neni 7

Në nenin 12 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me propozim të Presidentit, zgjedh nga radhët e anëtarëve të zgjedhur nga Kuvendi një Zëvendëskryetar.”

b) Pika 3 shfuqizohet.

c) Pika 4 shfuqizohet.

#### Neni 8

Në nenin 14, pas pikës 5, shtohen pikat 6 dhe 7 me këtë përmbajtje:

“6. Për Kryeinspektorin dhe inspektorët, jo më pak se një herë në 2 vjet, kryhet vlerësimi profesional dhe etik, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

7. Brenda tremujorit të parë të çdo viti, Inspektorati, nëpërmjet Kryeinspektorit, i paraqet Këshillit të Lartë të Drejtësisë një raport mbi veprimtarinë e tij në vitin paraardhës, në të cilin duhet të gjejnë pasqyrim problematikat e trajtuara dhe rezultatet e punës.

Raporti i përgatitur nga Inspektorati paraqitet nga Zëvendëskryetari për diskutim në mbledhjen më të afërt të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.”

#### Neni 9

Në nenin 19, pika 1, fjalia e parë ndryshohet si më poshtë:

“1. Kryetari vendos për datën dhe kohën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, por jo më rrallë se një herë në muaj.”

#### Neni 10

Neni 21 ndryshohet si më poshtë:

#### “Neni 21

1. Në rastet e arrestit, heqjes së lirisë në çfarëdo lloj forme, ushtrimit të kontrollit personal ose të banesës së gjyqtarit, Këshilli i Lartë i Drejtësisë mbledhet brenda 24 orëve dhe vendos për kërkesën e paraqitur nga prokurori në përputhje me nenin 137, pika 4, të Kushtetutës.

2. Në rastin kur një gjyqtar merr cilësinë e të pandehurit, Këshilli i Lartë i Drejtësisë vendos pezullimin e gjyqtarit nga detyra derisa të merret vendim gjyqësor i formës së prerë.

3. Në rastet kur fajësia nuk provohet me vendim gjyqësor të formës së prerë të gjykatës, Këshilli i Lartë i Drejtësisë vendos heqjen e pezullimit.

4. Këshilli i Lartë i Drejtësisë zhvillon mbledhje të jashtëzakonshme edhe në raste të tjera të veçanta kur kërkohet nga Kryetari, Zëvendëskryetari, Ministri i Drejtësisë ose nga jo më pak se pesë prej anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.”

#### Neni 11

Në nenin 26, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Në qoftë se Këshilli i Lartë i Drejtësisë rrëzon masën disiplinore të propozuar nga ministri, Këshilli i Lartë i Drejtësisë mund të vendosë një masë disiplinore më të lehtë.”

#### Neni 12

Në nenin 27 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pikat 1 dhe 2 ndryshohen si më poshtë:

“1. Zëvendëskryetari merr masat e nevojshme për regjistrimin në mënyrë të plotë audio dhe zbardhjen e procesverbalit të mbledhjes së Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

2. Në procesverbal pasqyrohet, data dhe vendi i mbledhjes, anëtarët që morën pjesë, rendi i ditës, çështjet që janë diskutuar, diskutimet e pjesëmarrësve, propozimet e bëra, vendimet e marra, forma, rezultati



dhe mënyra e votimit nga çdo anëtar. Procesverbali i mbledhjes dhe vendimet e marra duhet të zbardhen brenda 5 ditëve nga përfundimi i mbledhjes dhe publikohen menjëherë në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Procesverbali i zbardhur dhe vendimet nënshkruhet nga Zëvendëskryetari.”

b) Pas pikës 5 shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:

“6. Vendimet e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, së bashku me regjistrimet e plota audio dhe procesverbalet e zbardhura të mbledhjeve depozitohen pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.”

Neni 13

Pas nenit 30 shtohet neni 30/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 30/1

#### **Emërimi i kryetarëve të gjykatave**

1. Vendi vakant për pozicionin e kryetarit të gjykatës shpallet si i tillë 3 (tre) muaj përpara përfundimit të mandatit katërvjeçar të kryetarit të gjykatës. Afati tremujor shërben për evidentimin e kandidaturave që konkurrojnë në pozicionin e kryetarit të gjykatës dhe mbledhjen e materialeve dhe të dhënave, mbi bazë të të cilave do të bëhet përzgjedhja.

2. Emërimi i kryetarit të ri nuk mund të bëhet përpara deklarimit të mbarimit të mandatit të plotë të kryetarit ekzistues dhe në çdo rast jo më vonë se një muaj nga mbarimi i mandatit të tij.

3. Në rastet kur vendi i kryetarit në një gjykatë mbetet vakant për një nga situatat e mbarimit të mandatit përpara afatit ligjor, Këshilli i Lartë i Drejtësisë delegon një nga gjyqtarët e kësaj gjykate për të kryer përkohësisht detyrën e kryetarit të gjykatës. Vendi vakant, në këtë rast, duhet të plotësohet brenda tre muajve nga krijimi i tij.

4. Kryeinspektori i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, një herë në dy vjet ose kur kërkohet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, paraqet përpara Këshillit një raport për punën e kryer nga kryetari i gjykatës. Raporti i Kryeinspektorit bazohet edhe në:

a) raportin e të deleguarit pjesëmarrës të Këshillit të Lartë të Drejtësisë në analizat vjetore të gjykatës, e veçanërisht për punën e kryetarit;

b) vizitat e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë në gjykata gjatë mandatit të kryetarit;

c) materiale që vijnë nga Ministri i Drejtësisë;

ç) materiale të tjera që rezultojnë nga verifikimet apo kontrollet gjatë periudhës që ai ka qenë në detyrën e kryetarit të gjykatës.

5. Shqyrtimi i kandidaturave bëhet nga një komision i posaçëm, i cili kryesohet nga Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

6. Përbërja, rregullat e funksionimit të komisionit të shqyrtimit të kandidatëve dhe procedurat e verifikimit dhe të testimi të tyre caktohen nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.”

Neni 14

Në nenin 33, pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“2/1. Shqyrtimi i procedimit disiplinor bëhet brenda një muaji nga data e depozitimit të dokumentacionit përkatës nga Ministri i Drejtësisë, pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.”

Neni 15

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Ilir Meta

Miratuar në datën 31.7.2014

#### **LIGJ Nr. 103/2014**

### **PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË SË SIGURISË KOMBËTARE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Miratimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për miratimin e akteve nënligjore për zbatimin e kësaj strategjie.

Neni 3

Ligji nr. 9322, datë 25.11.2004, “Për miratimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë”, shfuqizohet.



Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI  
Ilir Meta**

Miraturar në datën 31.7.2014

## STRATEGJIA E SIGURISË KOMBËTARE

Tiranë, korrik 2014

Pasqyra e lëndës

Parathënie

I. Koncepti i Strategjisë së Sigurisë Kombëtare

- Qëllimi i Strategjisë së Sigurisë Kombëtare
- Vlerat kombëtare
- Interesat Strategjike të Shqipërisë
- Përgjegjësia strategjike
- Kuptimi ynë i mjedisit strategjik
- Vendosja e përparësive për të garantuar sigurinë kombëtare

II. Domosdoshmëritë strategjike

1. Përmirësimi i sundimit të ligjit dhe qeverisjes së mirë

2. Forcimi i institucioneve publike
3. Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik
4. Zhvillimi i një sistemi arsimor cilësor
5. Fuqizimi i Sektorit të Sigurisë dhe Mbrojtjes
6. Forcimi i kohezionit shoqëror dhe identitetit kombëtar

7. Forcimi i rolit rajonal dhe ndërkombëtar të Shqipërisë

8. Përshpejtimi i procesit të integritetit në Bashkimin Europian

9. Objektiva të tjerë

III. Zbatimi dhe përgjegjësitë

IV. Përfundime

Shtojca A – Qasja e re për funksionimin e arkitekturës së sigurisë

Shtojca B – Analiza e rrethave të rrethimit

Shtojca C – Klasifikimi i rrethimit

*Në themel të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë është aspirata e popullit shqiptar dhe vullneti politik për të realizuar vizionin e përbashkët, për një atdhe që garanton siguri, drejtësi, barazi dhe mirëqenie për të sotmen dhe brezat e ardhshëm; një vend i lirë, demokratik dhe i zhvilluar, anëtar i përkushtuar i NATO-s dhe i integruar në Bashkimin Europian.*

*Strategjia buron nga detyrimi kushtetues: për të garantuar sigurinë e vendit; për të forcuar liritë themelore, të drejtat e njeriut*

Faqe | 6288

*dhe shtetin e së drejtës; për të mbrojtur dhe promovuar interesat e shqiptarëve kudo që ndodhen; për të ruajtur dhe zhvilluar identitetin kombëtar. Strategjia mbështetet mbi vlerat kulturore dhe historike të popullit shqiptar dhe vokacionin e tij evropian.*

Parathënie

Siguria, liria dhe mirëqenia janë elemente thelbësore të shoqërive të civilizuar dhe përfaqësojnë themelet, mbi të cilat mbështetet zhvillimi dhe progresi i kombit. Garantimi i një mjedisi që ofron siguri dhe liri për qytetarët është përgjegjësia parësore e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare (SSK) të Republikës së Shqipërisë (RSH).

Shqipëria trashëgon një kulturë të pasur dhe histori komplekse. Kombi shqiptar është përballur dhe ka kapërcyer sfida të shumta, të cilat kanë përcaktuar zhvillimin dhe kanë formësuar karakterin e tij.

Shqyrtimi i mjedisit strategjik nxjerr në pah se rrethet ndaj sigurisë kombëtare nuk janë të izoluar nga njëra-tjetra, por të lidhura dhe të ndërvarura. Siguria jonë ndikohet nga një ndërthurje e rrethave tradicionale dhe jotradicionale, që burojnë nga faktorë të brendshëm dhe të jashtëm.

Strategjia është përfaqëse kombëtare e integruar dhe proaktive, me qëllim parashikimin dhe përgatitjen e përgjigjes më të përshtatshme ndaj këtyre rrethave, duke njohur dhe shfrytëzuar të gjitha mundësitë që ofron mjedisi strategjik.

Mënyrat dhe rrugët që zgjedhim sot për të përfituar nga mundësitë dhe për t'u përballur me rrethet, do të përcaktojnë të ardhmen e kombit nesër.

I. Koncepti i Strategjisë së Sigurisë Kombëtare

Qëllimi i Strategjisë së Sigurisë Kombëtare

SSK-ja është dokumenti më themelor planifikues për sigurinë kombëtare të RSH-së. Qëllimi i saj është të udhëheqë vendin në përmbushjen e përparësive kombëtare të sigurisë nëpërmjet një procesi planifikimi dhe vendimmarrjeje strategjike.

Zbatimi i kësaj strategjie kërkon angazhim dhe qasje mbarëkombëtare. SSK-ja thekson idealet dhe vlerat kombëtare, dhe kërkon kontributin e çdo shqiptari për të garantuar përmbushjen dhe vazhdimësinë e tyre. Plotësimi i domosdoshmërive strategjike kërkon mirëkuptimin dhe angazhimin e të gjithë popullit shqiptar, për të bërë zgjedhje të vështira që garantojnë sigurinë, përmirësojnë jetën dhe përmbushin aspiratat për të ardhmen.

SSK-ja do të realizohet përmes krijimit dhe rritjes së kapaciteteve institucionale të vendit për të siguruar bashkërendimin e përpjekjeve dhe përdorimin efikas



të burimeve kombëtare. Qasja e re ndaj modelit të bashkëpunimit është paraqitur në shtojcën A të këtij dokumenti.

Vlerat kombëtare

Kombi shqiptar mbështetet mbi vlerat e tij historike të lirisë, paqes me fqinjët dhe kombet e tjera, bashkëjetesës dhe harmonisë ndërfetare. Këto janë vlera qytetëruese që rrezatojnë në botë dhe kontribuojnë në të ardhmen europiane të rajonit.

Interesat strategjike të Shqipërisë

Mbrojtja dhe konsolidimi i sovranitetit, integritetit territorial dhe pavarësisë së RSH-së, rendit kushtetues demokratik, zhvillimi i të drejtave dhe lirive themelore, ruajtja e identitetit dhe e vlerave kombëtare, si dhe rritja e mirëqenies së shoqërisë është interesi jetik kombëtar.

Rëndësi strategjike për Shqipërinë ka paqja, stabiliteti dhe begatia e rajonit. Interesi ynë për një rajon të integruar në strukturat europiane dhe euroatlantike, ku mbizotëron harmonia ndëretnike dhe ndërfetare, realizohet përmes marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, bashkëpunimit në mirëbesim, respektimit të pakicave dhe gjithëpërfshirjes.

Përgjegjësia strategjike

Brezi ynë mban përgjegjësi historike për krijimin e një mjedisi që do t'i shërbejë mirëqenies dhe sigurisë së gjeneratave të ardhshme. Për këtë qëllim, do të veprimë me guxim, si individë dhe shoqëri, duke dëshmuar kurajë qytetare dhe vullnet politik, për t'u përballur me sfidat dhe për të shfrytëzuar mundësitë e kohës tonë. Veprimet tona sot përcaktojnë trashëgiminë që do t'u lëmë brezave të ardhshëm.

Kuptimi ynë i mjedisit strategjik

SSK-ja është bazuar mbi një analizë të plotë, të të gjitha elementeve të sigurisë kombëtare, rezultat i një procesi ndër-institucional, me përfshirjen edhe të shoqërisë civile. Ky proces shqyrtoi tërësinë e përparësive, dobësive, mundësive që ofron mjedisi strategjik dhe rreziqeve me të cilat përballlet vendi.

Mjedisi strategjik karakterizohet nga një kompleksitet në rritje dhe një nivel parashikueshmërie në ulje. Rreziqet e tanishme ndaj sigurisë kombëtare janë më të ndërlikuara dhe të ndërvarura se në të kaluarën. Ato ndërthurin kërcënimet tradicionale konvencionale dhe ato jokonvencionale, të shkaktuara nga krimi i organizuar, individë të korruptuar, terrorizmi, përhapja e armëve të shkatërrimit në masë dhe armëve me rreze të largët veprimi, përfshirë rreziqet ekonomike, politike dhe ndaj qeverisjes së mirë. Vlerësimi, analiza dhe klasifikimi i rreziqeve janë paraqitur në shtojcat B dhe C.

Me gjithë tendencën e qartë pozitive, siguria e vendit vijon ende të jetë e varur ndjeshëm edhe nga rreziqe me natyrë të brendshme. Ato burojnë mbi të gjitha nga korrupsioni dhe krimi i organizuar, të cilat cenojnë shtetin e së drejtës, institucionet tona kombëtare dhe prosperitetin e ekonomisë. Këto rreziqe komplekse mbartin, gjithashtu, edhe komponentë të jashtëm, duke krijuar sfida të reja në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe kohezionin social.

Rreziqet e jashtme nuk janë më vetëm konvencionale, por edhe me natyrë hibride, rrjedhojë e veprimtarive të organizatave kriminale ndërkombëtare, grupeve terroriste, forcimit të aktorëve joshitetorë, si dhe ndryshimeve klimaterike dhe demografike globale.

Pavarësisht këtyre rreziqeve, vendi ka aftësi për të ushtruar kontroll të mjaftueshëm mbi ngjarjet që kanë burim të brendshëm. Këto aftësi maksimalizohen përmes proceseve të mençura të vendimmarrjes. Anëtarësia në NATO, afrimi i vazhdueshëm me Bashkimin Europian dhe prania aktive në sistemet e tjera të sigurisë ndërkombëtare paraqesin një garanci të besueshme për përballjen me faktorët e rrezikut me burim të jashtëm.

Kuptimi dhe trajtimi tërësor i mjedisit strategjik krijon mundësinë për të marrë vendimet e duhura, për të përfutur nga mundësitë dhe për të minimizuar ekspozimin e vendit ndaj rreziqeve. Mënyra se si ne do të qasemi ndaj sfidave dhe mundësive do të jetë përcaktuese për të ardhmen tonë.

Vendosja e përparësive për të garantuar sigurinë kombëtare

Me gjithë arritjet historike, siguria kombëtare nuk mund të konsiderohet si e mirëqenë. Realizimi i saj është një proces i pandërprerë dhe varet nga aftësitë për të vendosur dhe përmbushur objektivat që garantojnë sigurinë e vendit. Suksesi i këtij procesi kushtëzohet nga përfshirja e të gjithë aktorëve kombëtarë dhe bashkëpunimi i ngushtë me aktorët ndërkombëtarë. Përcaktimi i rrugës drejt së ardhmes kërkon që t'i jepet prioritet përmbushjes së objektivave më të rëndësishëm, me qëllim hedhjen e themeleve të qëndrueshme për realizimin e interesit strategjik.

Qëllimi ynë parësor është konsolidimi i një demokracie funksionale dhe zhvillimi i një ekonomie tregu të qëndrueshme dhe konkurruese. Ky qëllim përmbushet duke njohur në mënyrë kritike gabimet e kryera gjatë tranzicionit nga komunizmi në demokraci.



Zhvillimi ekonomik i vendit dhe rritja e shkallës së integritimit dhe konkurrueshmërisë në tregjet rajonale dhe globale, është i lidhur në mënyrë të pandashme me forcimin e institucioneve, transparencën në mirëqeverisje dhe një administratë profesionale dhe meritokratike.

Sundimi i ligjit dhe qeverisja e mirë duhet të zbatohen në mënyrë të njëtrajtshme për të gjithë qytetarët shqiptarë pa përjashtim.

## II. Domosdoshmëritë strategjike

1. Përmirësimi i sundimit të ligjit dhe qeverisjes së mirë

Sundimi efektiv i ligjit dhe qeverisja e mirë garantojnë trajtim të drejtë dhe të barabartë për të gjithë qytetarët dhe mundësojnë pjesëmarrjen e tyre aktive në zhvillimin dhe prosperitetin e vendit. Këto janë elemente thelbësore të një shoqërie që kërkon një demokraci të konsoliduar.

Kuadri ligjor i RSH-së është hartuar dhe vijon të zhvillohet në përputhje me parimet dhe standardet e BE-së. Ligjet e vendit duhet të zbatohen me rigorozitetin që nevojitet për të vendosur besimin në institucionet tona, për të nxitur zhvillimin e ekonomisë dhe për të rritur pjesëmarrjen e qytetarëve.

Garantimi i zbatimit të barabartë të ligjeve për të gjithë shoqërinë është domosdoshmëri strategjike për të ndërtuar një demokraci të konsoliduar dhe një ekonomi të zhvilluar.

Korrupsioni apo perceptimi mbi nivelin e tij, minon besimin e publikut të qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit, si dhe dekurajon investimet e brendshme dhe të huaja, të nevojshme për të krijuar mundësi punësimi për të gjithë.

Përmirësimi i sundimit të ligjit dhe qeverisjes së mirë do të arrihet duke:

- Modernizuar dhe forcuar sistemin e drejtësisë, përmes reformave të gjithanshme dhe të matshme, të bazuara në parimet e Kushtetutës dhe praktikave më të mira europiane;

- Zbatuar një strategji për të rritur efektivitetin e gjyqësorit, duke shmangur hapësirat për korrupsion dhe krijuar një sistem efektiv, llogaridhënës, të përgjegjshëm, transparent dhe që lufton pandëshkueshmërinë;

- Hartuar dhe zbatuar strategji ndërsektoriale për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar, nxitur praktika të reja për përmirësimin e zbatimit të ligjit, si dhe rritur kapacitetet për të luftuar krimet komplekse;

- Rritur bashkëpunimin e institucioneve shtetërore me shoqërinë civile dhe qytetarët, për zhvillimin e programeve edukative për të luftuar si korrupsionin,

ashtu dhe indiferencën ndaj praktikave korruptive.

Objektiva mbështetës:

- Shtimi dhe promovimi i shërbimeve digjitale dhe e-shërbimeve për qytetarët dhe biznesin, me qëllim rritjen e transparencës dhe përmirësimin e shërbimeve të administratës publike;

- Forcimi i kontrollit dhe administrimit të territorit nga agjencitë e zbatimit të ligjit dhe autoritetet vendore;

- Zbatimi i masave të reja për shmangien e evazionit fiskal dhe informalitetit në ekonomi.

2. Forcimi i institucioneve publike

Zhvillimi i ekonomisë dhe rritja e sigurisë së vendit mbështetet në institucione të qëndrueshme që i përgjigjen nevojave të shoqërisë. Dobia e tyre matet me efikasitetin dhe efektivitetin e shërbimeve që ofrojnë. Institucionet e forta fitojnë dhe rrisin besimin e qytetarëve të sundimi i ligjit dhe qeverisja e mirë. Ato krijojnë një klimë të favorshme për tërheqjen e investimeve të huaja direkte në masë të konsiderueshme.

Zhvillimi i një administrate publike profesionale, meritokratike dhe të pavarur nga faktorët partiakë të politikës është një direktivë strategjike.

Forcimi i institucioneve publike do të arrihet duke:

- Zbatuar një plan strategjik për reformimin e administratës publike nëpërmjet institucionalizimit të procedurave të meritokracisë dhe të profesionalizimit, krijimit të mundësive për karrierë të gjatë dhe të ndershme, si dhe vendosja e raporteve optimale mes përmasave dhe dobisë së saj;

- Aftësuar administratën publike dhe institucionet vendore, për të vepruar në mënyrë efektive përmes delegimit të autoritetit, përgjegjësisë dhe kompetencave, duke u siguruar edhe kapacitetet e nevojshme financiare, logjistike dhe infrastrukture;

Zhvillimi i një koncepti strategjik për të mirat detare	Ministria e Ekonomisë	Ministria e Energjetikës	Ministria e Bujqësisë	Ministria e Turizmit	Ministria Mjedisit	Ministria e Brendshme	Ministria e Mbrojtjes
Zbatim i politikave që mbështesin prodhimin dhe nxisin eksportet	Ministria Ekonomisë	Ministria e Bujqësisë	Ministria e Energjisë & Industrisë	Ministria e Financave	Ministria e Integritit	Ministria e Punëve të Jashtme	Ministria e Inovacionit
Zbatim i Planit Kombëtar të Transportit	Ministria e Transportit	Ministria e Financave	Ministria e Ekonomisë	Ministria e Brendshme	Ministria e Punëve të Jashtme		
Zbatim i politikave për zhvillimin e burimeve natyrore	Ministria e Energjetikës dhe Industrisë	Ministria e Mjedisit	Ministria e Ekonomisë	Ministria e Inovacionit			

**DOMOSDOSHMERIA STRATEGJIKE 4 – ZHVILLIMI I NJË SISTEMI ARSIMOR CILËSOR**

Objektivat	Institucioni përgjegjës kombëtar	Institucione mbështetëse					
Zbatohet një strategji afatgjatë në të gjitha nivelet e arsimit dhe kërkimit shkencor	Ministria e Arsimit	Ministria e Inovacionit	Ministria e Financave	Universitet Publike	Grupet e interesit		
Zbatim i strategjisë për integrimin e ekonomisë me arsimin	Ministria e Arsimit	Ministria e Ekonomisë	Ministria e Çështjeve Sociale	Ministria e Inovacionit	Ministria e Financave	MPJ	Ministria e Integritit
Zhvillimi i një procesi për vlerësimin e vlefshmërisë së politikave dhe programeve tona arsimore	Ministria e Arsimit	Universitetet publike	Grupet e interesit	Ministria e Inovacionit			
Krijimi i një sistemi edukimi dhe trajnimi për shfrytëzimin efektiv të teknologjisë e telekomunikacionit	Ministria e Arsimit	Ministria e Inovacionit	Ministria e Financave				

**DOMOSDOSHMERIA STRATEGJIKE 5 – KONSOLIDIMI I SEKTORIT TË MBROJTJES DHE SIGURISË**

Objektivat	Institucion përgjegjës kombëtar	Institucione mbështetëse					
Hartimi i Strategjisë Ushtarake	Ministria e Mbrojtjes	Ministria e Financave					
Zbatim i RSM 2013	Ministria e Mbrojtjes	Ministria e Financave					
Reforma e sistemit të policimit	Ministria e Brendshme	Ministria e Financave	Ministrinë që kanë në vartësi struktura policore				
Amendimi i kuadrit ligjor për zbatimin e detyrimeve të NATO-s	Ministria e Mbrojtjes	Ministria e Drejtësisë	Ministria e Punëve të Jashtme				
Fuqizimi dhe modernizimi i Policisë së Shtetit	Ministria e Brendshme	Ministria e Financave	Ministria e Drejtësisë	Ministrinë që kanë në vartësi struktura policore			
Miratimi i Strategjisë për Reduktimin e Rrezikut ndaj Fatkeqësive dhe Mbrojtjes Civile	Ministria e Brendshme	Ministria e Mbrojtjes	Ministria e Energjisë	Ministria e Shëndetësisë	Ministria e Mjedisit	Ministria e Bujqësisë	Ministria e Transporteve
Ngritja e Qendrës Kombëtare të Emergjencave Civile dhe Krizave	Kryeministria	Ministria e Brendshme	Ministria e Mbrojtjes	MPJ	Ministria e Financave	Ministria e Drejtësisë	Ministria e Shëndetësisë
Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar	Ministria e Brendshme	Shërbimet e Inteligjencës	Ministria e Drejtësisë	MPJ	Ministria e Mbrojtjes	Prokuroria	
Standardizimi i legjislacionit mbi bashkëpunimin e agjencive të inteligjencës	Kryeministria	Shërbimet e Inteligjencës	Ministria e Drejtësisë	Agjencitë ligjzbatuese	Ministria e Financave	Ministria e Brendshme	Ministria e Mbrojtjes
Ndërtimi i rrjetit kombëtar të komunikimit të sigurt	Ministria e Inovacionit	Institucionet e vartësisë	DSIK	MPJ	Ministria e Mbrojtjes	Agjencitë e Inteligjencës	

**DOMOSDOSHMERIA STRATEGJIKE 6 – FORCIMI I KOHEZIONIT SHOQËROR DHE IDENTITETIT KOMBËTAR**

Objektivat	Institucion përgjegjës kombëtar	Institucione mbështetëse				
Hartimi i planit kombëtar për mësimin e gjuhës dhe kulturës në diasporë	Ministria e Kulturës	Ministria Arsimit	Ministria e Financave	Ministria e Punëve të Jashtme	Institucionet akademike	
Zgjidhja e çështjes së pronës, legalizimi i zonave urbane	Ministria e Drejtësisë	Ministria e Zhvillimit Ekonomik	Ministria e Financave	ALUIZNI		
Përfundimi i procesit të dëmshpërblimit të përndjekurve politikë	Ministria e Çështjeve Sociale	Ministria e Financave	Ministria e Drejtësisë			
Rritja e bashkëpunimit me shoqërinë civile në edukimin kundër radikalizmit	Instituti i kulteve	Ministria e Çështjeve Sociale	Ministria e Arsimit	Ministria e Kulturës	Ministria e Financave	



Mbrojtja e trashëgimisë kulturore materiale dhe jo materiale	Ministria e Kulturës	Ministria e Financave	Ministria Arsimit	Arkiva e shtetit	Institucionet akademike
Zbatimi i standardeve më të larta për respektimin e pakicave	Kryeministria	Ministria e Punëve të Jashtme	Ministria e Drejtësisë	Ministria e Çështjeve Sociale	Komiteti i Minoriteteve
Rritja e aksesit për grupet e marginalizuara	Ministria e Çështjeve Sociale	Ministria e Financave	Ministria e Drejtësisë	Ministri e Integritimit	Ministria e Ekonomisë
Përparimi i barazisë gjinore	Ministria e Çështjeve Sociale	Ministria e Financave	Ministria e Integritimit	Ministria e Ekonomisë	

**DOMOSDOSHËRIA STRATEGJIKE 7 – FORCIMI I ROLIT RAJONAL DHE NDËRKOMBËTAR TË SHQIPËRISË**

Objektivat	Institucion përgjegjës kombëtar	Institucione mbështetëse							
		Ministria e Integritimit	Ministria e Drejtësisë	Ministria e Brendshme	Ministria e Mbrojtjes	Ministria e Mjedisit			
Angazhim për zgjidhjen e problemeve të trashëguara në rajon	Ministria e Punëve të Jashtme								
Ndjekja e përmeshjes së të drejtave të shqiptarëve në rajon	Ministria e Punëve të Jashtme								
Bashkëpunimi rajonal për heqjen e barrierave	Ministria e Punëve të Jashtme	Ministria e Zhvillimit Ekonomik	Ministria e Brendshme	Ministria e Drejtësisë	Ministria e Integritimit				
Hapja drejt qendrave të reja ekonomike botërore	Ministria e Punëve të Jashtme	Ministria e Zhvillimit Ekonomik	Ministria e Financave	Ministria e Transportit	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	Ministria e Bujqësisë	Ministria e Turizmit	Ministria e Çështjeve Sociale	Ministria e Inovacionit
Shfrytëzimi i potencialeve të partneriteteve strategjike	Ministria e Punëve të Jashtme	Ministria e Zhvillimit Ekonomik	Ministria e Financave	Ministria e Transportit	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	Ministria e Bujqësisë	Ministria e Turizmit	Ministria e Çështjeve Sociale	Ministria e Inovacionit
Nxjtja e një imazhi të ri të Shqipërisë	Kryeministria	Ministria e Punëve të Jashtme	Ministria e Kulturës	Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit	Ministria e Inovacionit				
Reformimi i shërbimit të jashtëm	Ministria e Punëve të Jashtme	Ministria e Financave	Ministria e Inovacionit						

**DOMOSDOSHËRIA STRATEGJIKE 8 – PËRSHPEJTIMI I PROCESIT TË INTEGRIMIT NË BASHKIMIN EUROPIAN**

Objektivat	Institucion përgjegjës kombëtar	Institucione mbështetëse				
		Ministria e Integritimit	Ministria e Drejtësisë	Ministria e Brendshme	Ministria e Financave	Ministria e Integritimit
Përmeshja e kriterëve të Kopenhagenit	Ministria e Integritimit	Institucionet përkatëse sipas kapitujve				
Harmonizimi i legjislacionit me <i>acquis communautaire</i>	Ministria e Integritimit	Ministria e Drejtësisë	Institucionet përkatëse sipas fushave			
Detyrimet në kuadër të Politikës së Jashtme dhe Sigurisë të BE-së.	Ministria e Punëve të Jashtme	Ministria e Mbrojtjes	Ministria e Brendshme	Ministria e Financave	Ministria e Integritimit	

**DOMOSDOSHËRIA STRATEGJIKE 9 – OBJEKTIVA TË TJERË**

Objektivat	Institucion përgjegjës kombëtar	Institucione mbështetëse			
		Ministria e Financave	Ministria e Brendshme	Ministria e turizmit dhe zhvillimit urban	Ministria e Drejtësisë
Parandalimi i degradimit mjedisor	Ministria e Mjedisit	Ministria e Financave	Ministria e Brendshme	Ministria e turizmit dhe zhvillimit urban	Ministria e Drejtësisë
Siguria e komunikimit elektronik	Ministria e Inovacionit	Ministria e Financave			



Siguria shëndetësore dhe parandalimi i pandemive	Ministria e Shëndetësisë	Ministria Financave			
Siguria ushqimore dhe ndihma sociale	Ministria e Bujqësisë	Ministria Financave	Ministria e Çështjeve Sociale	Pushteti Vendor	

**LIGJ**  
**Nr. 104/2014**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË  
LIGJIN NR. 7703, DATË 11.5.1993, “PËR  
SIGURIMET SHOQËRORE NË  
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË  
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

**Neni 1**

Neni 1 ndryshohet si më poshtë:

**“Neni 1**

**Sistemi i përgjithshëm i sigurimeve shoqërore**

Ligji për sigurimet shoqërore të Republikës së Shqipërisë rregullon marrëdhëniet në fushën e sigurimeve shoqërore.

Sistemi i përgjithshëm i sigurimeve shoqërore përbëhet nga:

- sigurimet shoqërore të detyrueshme;
- sigurimi shoqëror vullnetar;
- sigurimi shoqëror suplementar;
- pensionet shtetërore të posaçme;
- pensionet sociale;
- fondet profesionale dhe fondet e pensionit vullnetar.”.

**Neni 2**

Në nenin 2, paragrafi i dytë, i tretë dhe i katërt shfuqizohen.

**Neni 3**

Neni 4 ndryshohet si më poshtë:

**“Neni 4**

**Sigurimi shoqëror suplementar**

1. Sigurimi shoqëror suplementar mbron me të ardhura:

- Personat që ushtrojnë funksione ose detyra të veçanta kushtetuese dhe personat me tituj shkencorë;
- Punonjësit e shtetit, ushtarakët që shërbejnë në strukturat e Forcave të Armatosura, punonjësit e Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, punonjësit e Shërbimit për Ankesat dhe Çështjet e Brendshme.

2. Kriteret për sigurim shoqëror suplementar të kategorive, të përfshira në pikën 1 të këtij neni, përcaktohen me ligje të veçanta.

3. Skemë të sigurimit shoqëror suplementar, sipas kushteve të përcaktuara me ligj të veçantë, ka të drejtë të ngrejë çdo person juridik, me kapital shtetëror ose pjesërisht shtetëror, i autorizuar nga Këshilli i Ministrave.”.

**Neni 4**

Pas nenit 5 shtohen nenet 5/1 dhe neni 5/2 me këtë përmbajtje:

**“Neni 5/1**

**Pensioni social**

Pensioni social është një përfitim që i jepet çdo shtetasi shqiptar, i cili ka mbushur moshën 70 vjeç, është me qëndrim të përhershëm në Shqipëri të paktën për pesë vitet e fundit, nuk plotëson kushtet për asnjë lloj pensioni nga skema e detyrueshme e sigurimeve shoqërore dhe nuk ka të ardhura ose të ardhurat, që përfiton nga çdo burim tjetër, janë më të ulëta se të ardhurat që jep pensioni social.

Masa e pensionit social është e barabartë me të ardhurat minimale që sigurohen nga pensioni i pjesshëm i pleqërisë me 15 vite të siguruar me pagë minimale, i llogaritur në datën 31.12.2014.

Masa e pensionit social për personat që kanë të ardhura nga burime të tjera do të jetë sa diferenca e pensionit social me të ardhurat e tjera që ka përfituesi.

Kriteret, procedurat dhe dokumentacioni për pensionin social përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.



Neni 5/2

### Fondet profesionale dhe fondet e pensionit vullnetar

Krijimi, veprimtaria dhe mbikëqyrja e fondeve profesionale dhe fondeve të pensionit vullnetar bëhen sipas ligjit të veçantë.”

Neni 5

Në nenin 9 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Paragrafi i tretë ndryshohet si më poshtë:

“Personat e tjerë ekonomikisht aktivë janë të detyruar të paguajnë kontribut mujor për barrë lindje dhe për pensione të llogaritura për një pagë jo më të vogël se paga minimale në shkallë vendi dhe jo më të lartë se paga maksimale kontributive.”

2. Pas paragrafit të tretë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Punonjësit e papaguar të familjes, që punojnë e bashkëjetojnë me të vetëpunësuarin, paguajnë kontribut për barrë lindje dhe për pensione mbi bazën e pagës minimale në shkallë vendi.”

Neni 6

Në nenin 10, paragrafi i dytë dhe paragrafi i tretë ndryshohen si më poshtë:

“Kontributi llogaritet dhe paguhet mbi pagën bruto, brenda kufijve të pagës minimale në shkallë vendi dhe pagës maksimale për efekt kontributi për sigurimet shoqërore, miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, e cila është në fuqi në datën 31.12.2014. Pas datës 1.1.2015, paga maksimale për efekt kontributi indeksohet në të njëjtën kohë dhe në atë masë që indeksohet paga minimale në shkallë vendi. Kontributi minimal për personin e punësuar, punëdhënësin dhe të vetëpunësuarin është i barabartë dhe llogaritet mbi bazën e pagës minimale në shkallë vendi.

Personat e vetëpunësuar në bujqësi paguajnë kontribut për pension dhe barrë lindje të llogaritur mbi pagën minimale në shkallë vendi. Pagesa e kontributit bëhet çdo tremujor.”

Neni 7

Në nenin 11, pas fjalëve “kontributi vullnetar” shtohen fjalët “llogaritet në kufijtë e pagës minimale dhe maksimale të caktuar nga Këshilli i Ministrave dhe”.

Neni 8

Neni 12 shfuqizohet.

Neni 9

Në nenin 13, pikat 3 dhe 4 ndryshohen si më poshtë:

“3. Personat e detyruar për derdhjen e kontributeve janë përgjegjës për llogaritjen dhe pagesën e tyre. Punëdhënësi është i detyruar të mbajë nga paga e të punësuarve kontributet dhe t'i derdhë ato në llogari të administratës tatimore, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara me ligjin nr. 9136, datë 11.9.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

4. Kontributet e të vetëpunësuarve në bujqësi dhe kontributet vullnetare derdhen në llogaritë e Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Kriteret dhe procedurat përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Inspektorët e kontributeve të sigurimeve shoqërore kanë të drejtë të kontrollojnë saktësinë e llogaritjes dhe afatet e pagesës së kontributeve. Çdo diferencë në shumën e kontributeve do të kthehet gjatë 5 vjetëve të pagesës së bashku me kamatëvonesën.”

Neni 10

Në nenin 16 bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

1. Në fund të paragrafit të dytë shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Masa e kamatëvonesës është sipas përcaktimeve të nenit 76, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.”

2. Paragrafi i tretë shfuqizohet.

Neni 11

Neni 22 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 22

### Shuma e të ardhurave

1. Të ardhurat për sëmundje janë 70 për qind e mesatares ditore të bazës së vlerësuar neto të gjashtë muajve të fundit nga data e lindjes së të drejtës, kur i siguruari ka deri në 10 vjet sigurim dhe 80 për qind kur i siguruari ka mbi 10 vjet sigurim.

2. Për periudhën që përfituesi është shtruar në spital, kur nuk ka njeri në ngarkim, të ardhurat për sëmundje janë 50 për qind e mesatares ditore të bazës së vlerësuar neto të gjashtë muajve të fundit nga data e lindjes të së drejtës.”



## Neni 12

Në nenin 24, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Shuma e së ardhurës, që do të përfitohet për kompensim, është e barabartë me diferencën ndërmjet pagës së vendit të punës së mëparshme dhe pagës së vendit të punës së re. Ky kompensim nuk mund të jetë më shumë se 50 për qind e mesatares ditore të bazës së vlerësuar neto të gjashtë muajve të fundit nga data e lindjes të së drejtës.”.

## Neni 13

Neni 27 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 27

### E ardhura për barrëlindje

1. E ardhura për barrëlindje i paguhet gruas së siguruar për barrën dhe lindjen e fëmijës, kur ajo ka 12 muaj periudhë sigurimi, për çdo rast përfitimi. Përfshihet nga rregulli për periudhën e sigurimit rasti kur e drejta e pagesës për barrëlindjen e radhës ndodh brenda 24 muajve nga data e lindjes së fëmijës së mëparshëm.

2. Periudha e përfitimit do të jetë 365 ditë kalendarike, duke përfshirë një minimum prej 35 ditësh para dhe 63 ditësh pas lindjes së fëmijës. Për gruan që do të ketë në barrë më shumë se një fëmijë, periudha e përfitimit do të jetë 390 ditë kalendarike, duke përfshirë një minimum prej 60 ditë para dhe 63 ditë pas lindjes së fëmijëve.

3. E ardhura për barrëlindje për gruan e siguruar është:

a) 80 për qind e mesatares ditore të bazës së vlerësuar neto të dymbëdhjetë muajve të fundit nga data e lindjes të së drejtës për pagesë për periudhën e paralindjes dhe për 150 ditë kalendarike pas lindjes;

b) 50 për qind e mesatares ditore të bazës së vlerësuar neto të dymbëdhjetë muajve të fundit nga data e lindjes së të drejtës për pagesë për periudhën tjetër në vazhdim.

4. E ardhura për barrëlindje për gratë e siguruar si të vetëpunësuar në bujqësi llogaritet sipas pikës 3, të këtij neni. Për periudhën deri në barazimin e kontributeve që paguajnë të vetëpunësuarit në bujqësi me të vetëpunësuarit në aktivitete jobujqësore, e ardhura për barrëlindje caktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Nëna, që birëson fëmijën e moshës deri në 1 vjeç dhe që ka qenë e siguruar jo më pak se 12 muaj, ka të drejtë për leje pas lindjes, e cila fillon ditën e

birësimit, por jo më parë se mbas ditës së 63-të të lindjes së fëmijës, dhe vazhdon jo më shumë se 330 ditë nga dita e lindjes së fëmijës. Minimumi i lejes për birësuesen është 28 ditë.

6. Kur një fëmijë është birësuar gjatë lejes së lindjes, nëna që ka lindur do të ketë një periudhë përfitimi deri në ditën e birësimit, por jo më pak se 63 ditë pas lindjes.

7. Pas periudhës prej 63 ditësh pas lindjes, të drejtën e lejes për kujdes ndaj fëmijës e ka edhe babai ose birësuesi i siguruar, nëse këtë të drejtë nuk e ushtron apo nuk ka kushte për ta përfituar nëna.”.

## Neni 14

Në nenin 28, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Shuma e të ardhurave që do të përfitohet për kompensim është e barabartë me diferencën ndërmjet pagës së vendit të punës të mëparshëm dhe pagës së vendit të punës së re. Ky kompensim nuk mund të jetë më shumë se 50 për qind e mesatares ditore të bazës së vlerësuar neto të dymbëdhjetë muajve të fundit nga data e lindjes të së drejtës për pagesë.”.

## Neni 15

Në nenin 30 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Shkronja “b” shfuqizohet.

2. Pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “ç/1” me këtë përmbajtje:

“ç/1) pension invaliditeti i reduktuar.”.

## Neni 16

Neni 31 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 31

### Pension pleqërie

1. Personat e siguruar, që kanë plotësuar jo më pak se 15 vite sigurim shoqëror, kanë të drejtë për pension pleqërie, kur të arrijnë moshën e përcaktuar në nenin 92, të këtij ligji.

2. Nënata, që kanë lindur 6 a më shumë fëmijë, të cilët janë rritur më shumë se 8 vjeç, kanë të drejtë të dalin në pension kur mbushin moshën 55 vjeç dhe kanë 30 vjet sigurim.”.

## Neni 17

Neni 31/1 ndryshohet si më poshtë:



“Neni 31/1

### **Pension pleqërie i reduktuar**

Personat e siguruar kanë të drejtë për pension pleqërie të reduktuar, deri tre vjet para mbushjes së moshës së daljes në pension të përcaktuar në nenin 92, kur:

- a) kanë plotësuar vitet e sigurimit sipas nenit 92;
- b) nuk kryejnë veprimtari ekonomike si të punësuar, punëdhënës ose të vetëpunësuar.

Pensioni i reduktuar është pjesë e pensionit të plotë dhe mbetet i reduktuar gjatë gjithë kohës së përfitimit. Ky pension llogaritet duke zbritur nga pensioni i plotë shumë më që del nga shumëzimi i numrit të muajve të përfitimit të pensionit, para mbushjes së moshës së përcaktuar në nenin 92, me koeficientin mujor të reduktimit. Koeficienti i reduktimit të pensionit të plotë të pleqërisë, për personat që plotësojnë kushtet e parashikuara në paragrafin e parë, të këtij neni, është 0,6 për qind në muaj.”

Neni 18

Neni 32 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 32

### **Masa e pensionit**

1. Pensioni mujor i pleqërisë përbëhet nga një shumë bazë dhe nga një shtesë.

2. Shuma bazë llogaritet si raport i periudhës së sigurimit që ka realizuar personi me periudhën e sigurimit të kërkuar, sipas nenit 92, shumëzuar me pensionin social.

3. Shtesa do të jetë 1 për qind për vit sigurimi shumëzuar me bazën mesatare të vlerësuar që personat e siguruar kanë arritur nëpërmjet kontributeve, e llogaritur sipas nenit 59, të këtij ligji.

4. Shuma e përgjithshme e pensionit nuk mund të jetë më e vogël se pensioni social.”

Neni 19

Neni 33 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 33

### **Shtesë pensioni për shtyrje të datës së daljes në pension**

I siguruari, i cili ka plotësuar kushtet për pension pleqërie, sipas nenit 92, të këtij ligji, merr shtesë në masën 0,5 për qind të pensionit për çdo muaj që shtyn datën e daljes në pension dhe vazhdon të paguajë kontribute.

Përfituesi i pensionit të pleqërisë, që ndërpret pensionin, vazhdon të punojë dhe paguan kontribute, merr shtesë mbi pension në masën 0,5 për qind për çdo muaj ndërprerjeje. Kjo shtesë llogaritet mbi atë masë pensioni që rezulton pas rritjeve dhe indeksimit që ka pësuar pensioni gjatë kohës së ndërprerjes.”

Neni 20

Neni 34 shfuqizohet.

Neni 21

Në nenin 35, pika 2, paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

“Periudha minimale e sigurimit për pension invaliditeti është sa 3/4 e diferencës së moshës së personit të siguruar në kohën që bëhet i paaftë dhe moshës 20 vjeç dhe në 5 vitet e fundit para lindjes së të drejtës të këtij së paku 12 muaj sigurim shoqëror.”

Neni 22

Neni 36 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 36

### **Shuma e pensionit**

1. Shuma e pensionit të invaliditetit të plotë llogaritet në të njëjtën mënyrë si pensioni i pleqërisë.

2. Shuma e përgjithshme e pensionit nuk mund të jetë më e vogël se 75 për qind e pagës minimale neto në shkallë vendi.”

Neni 23

Në nenin 38, në fund të fjalisë së parë, fjalët “të bazës së vlerësueshme” zëvendësohen me fjalët “të bazës së vlerësuar neto”.

Neni 24

Në nenin 40, pika 2, shkronja “a”, në paragrafin e fundit shprehja “50 vjeç” zëvendësohet me shprehjen “55 vjeç”.

Neni 25

Në nenin 41, pika 1, paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

“Pensioni familjar është pjesë e pensionit që kishte ose i takonte të ndjerit. Pensioni, që do t'i takonte të ndjerit, llogaritet sipas rregullave për pensionet e invaliditetit. Pensioni familjar jepet në masën.”

Neni 26

Në nenin 42, pika 2 ndryshohet si më poshtë:



“2. Pagesa për rast vdekjeje është e barabartë me 50 për qind të pagës minimale në shkallë vendi.”.

Neni 27

Neni 43 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 43

#### Llojet e përfitimeve

Personat e siguruar, në rastet e aksidenteve në punë ose sëmundjeve profesionale, përfitojnë të drejtën e së ardhurës, pavarësisht nga vjetërsia në punë:

- a) për kujdes mjekësor shtesë dhe riaftësimi;
- b) në rast paaftësie;
- c) për kompensim për dëme të arsyeshme;
- ç) në rast vdekjeje.”.

Neni 28

Neni 47 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 47

#### E ardhura për paaftësi të përkohshme

E ardhura për paaftësi të përkohshme, si pasojë e një aksidenti në punë ose sëmundjeve profesionale, e provuar nga një komision mjekësh ekspertë kompetentë (KML), do të jetë e barabartë me 100 për qind të mesatares ditore të bazës së vlerësuar neto të gjashtë muajve të fundit nga data e lindjes së të drejtës, paguar për një periudhë përfitimi deri në 12 muaj.”.

Neni 29

Neni 48 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 48

#### E ardhura për invaliditet të përhershëm

E ardhura për invaliditet të përhershëm në punë, që ka shkaktuar të paktën humbjen e 67 për qind të aftësisë për punë, e vërtetuar nga një Komision Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP), është e barabartë me 80 për qind të bazës së vlerësuar mesatare neto të vitit të fundit para lindjes së të drejtës, por jo më pak se 80 për qind e pagës minimale neto në shkallë vendi.

Personit, që përfiton të ardhura, sipas paragrafit të parë, të këtij neni, dhe ka nevojë për një kujdesje të vazhdueshme nga një person tjetër, sipas vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP), i jepet një pagesë shtesë prej 15 për qind të bazës së vlerësuar neto të vitit të fundit para lindjes së të drejtës.

Personi, që përfiton të ardhura, sipas paragrafit të parë, të këtij neni, dhe ka në ngarkim fëmijë deri në moshën 18 vjeç ose kur këta studiojnë apo janë të paaftë për punë deri në moshën 25 vjeç, përfiton një të ardhur shtesë familjare për çdo fëmijë në masën 5 për qind të pensionit, por jo më shumë se 30 për qind.”.

Neni 30

Neni 49 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 49

#### E ardhura për invaliditet të pjesshëm të përhershëm

E ardhura për invaliditet të pjesshëm të përhershëm në punë, që ka shkaktuar të paktën humbjen e 33 për qind të aftësisë për punë, e vërtetuar nga KMCAP-ja, është e barabartë me një pjesë të 80-përqindëshit të bazës mesatare të vlerësuar neto të vitit të fundit para lindjes së të drejtës, në varësi nga shkalla e humbjes së aftësisë për punë, por jo më pak se 50 për qind dhe që përcaktohet në rregulloren e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.”.

Neni 31

Neni 59 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 59

#### Baza e vlerësuar për llogaritjen e përfitimeve

1. Baza e vlerësuar për llogaritjen e pensioneve llogaritet si raport i shumës së pagave, për të cilat janë paguar kontributet, me periudhën që njihet si periudhë sigurimi.

Për periudhën e sigurimit nga data 1.1.1994 e në vazhdim, për llogaritjen e bazës së vlerësuar merret shuma e pagave, për të cilat janë paguar kontributet nga data 1.1.1994 deri në fund të periudhës së sigurimit.

Për periudhën e sigurimit në institucione dhe ndërmarrje shtetërore para datës 1.1.1994, për llogaritjen e bazës së vlerësuar merren pagat referuese, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Për periudhën e sigurimit në ish-kooperativat bujqësore, për llogaritjen e bazës së vlerësuar merren pagat referuese të caktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në rastet kur personi i siguruar ka periudhë sigurimi para dhe pas datës 1.1.1994, baza e vlerësuar llogaritet si mesatare aritmetike e ponderuar e bazës





së vlerësuar të periudhave të sigurimit si ish-punonjës i institucioneve apo ndërmarrjeve shtetërore dhe ish-anëtar i kooperativave bujqësore përpara vitit 1994, si dhe e periudhave të sigurimit si person i punësuar, i vetëpunësuar apo ekonomikisht aktiv pas datës 1.1.1994.

Për efekt të llogaritjes së pensioneve me datë fillimi pas 1.1.2015 e në vazhdim, baza e vlerësuar mesatare do të llogaritet bazuar në pagat referuese, sipas llojit të punës ose funksionit përpara datës 1.1.1994, si edhe mbi pagat individuale, mbi të cilat janë paguar kontributet sipas viteve, nga 1.1.1994 deri në 31.12.2014, të indeksuara me indeksin që del nga pjesëtimi i pagës minimale në shkallë vendi të vitit 2014 me pagën minimale të vitit 1994 ose me pagën minimale të vitit përkatës.

Koeficientët e indeksimit sipas viteve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Baza e vlerësuar neto për llogaritjen e pagesave për sëmundje e barrë lindje dhe për të ardhura të tjera afatshkurtra do të jenë pagat mbi të cilat janë paguar kontributet pasi zbritet tatimi mbi të ardhurat personale, norma e kontributit të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe suplementare që mbahet nga paga e punonjësit, sipas dispozitave në fuqi për periudhën përkatëse.

3. Çdo vit, pas 1.1.2015, duke filluar nga data 1 janar, baza e vlerësuar vjetore individuale indeksohet me koeficientin, që llogaritet si raport i kontributit mesatar të personave të siguruar, të mbledhur në vitin e fundit kalendarik, kundrejt të njëjtit tregues të vitit pararendës. Ky koeficient caktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Pensionet e invaliditetit nuk do të llogariten me një bazë të vlerësuar më të ulët se ajo e paguar më parë. Sapo të jetë përfituar një pension invaliditeti, shuma e pensionit do të merret si kufi minimal, kur llogaritet çdo pension tjetër sipas ligjit të sigurimeve shoqërore.”.

Neni 32

Neni 61 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 61

### **Indeksimi i përfitimeve**

Pensioni social, pensionet e pleqërisë, të invaliditetit, familjare si edhe të ardhurat nga aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale indeksohen çdo vit për të kompensuar pasojat e ndryshimit të çmimeve të mallrave dhe të shërbimeve

të zgjedhura për nivelin minimal të jetesës së pensionistëve. Këshilli i Ministrave cakton listën e mallrave të zgjedhura, mbi të cilën llogaritet indeksi, metodën e llogaritjes dhe datën e indeksimit.”.

Neni 33

Në nenin 64 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje: “Pensioni social financohet nga Buxheti i Shtetit.”

Neni 34

Në nenin 66, shkronja “d”, emërtimi “Kuvendi Popullor” zëvendësohet me emërtimin “Kuvendi i Republikës së Shqipërisë”.

Neni 35

Neni 70 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 70

### **Fondi rezervë**

1. Instituti i Sigurimeve Shoqërore krijon një fond rezervë që të mbulojë të paktën 1 muaj shpenzimet për pensione.

2. Rezerva të plotësohet gjatë 3 vjetëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Në çdo rast, kur fondi rezervë është nën nivelin përcaktues, merren masat e nevojshme për ta vendosur në kuotën e caktuar. Procedurat e plotësimit përcaktohen në statutin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore miratuar nga Këshilli i Ministrave.”.

Neni 36

Titulli i nenit 82 ndryshohet si më poshtë:

“Procedura për transferimin dhe pagimin e kontributeve”.

Neni 37

Në nenin 84, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Kërkesat, së bashku me dokumentet e përcaktuara në rregulloren e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, paraqiten në agjencitë lokale të Institutit të Sigurimeve Shoqërore ku ndodhet vendbanimi i përhershëm i personit.”.

Neni 38

Në nenin 85, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Përfitimet afatshkurtra për papunësinë caktohen nga zyrat e punësimit. Dokumentacioni, kriteret dhe procedurat e caktimit të tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.



Neni 39

Neni 87 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 87  
**Pagesat**

Pagesa e përfitimeve nga sigurimet shoqërore u ngarkohet institucioneve financiare profesionale, që do të caktohen nga Këshilli Administrativ i Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Pagesa për përfitimin e papunësisë bëhet nga institucione financiare profesionale ose nga zyrat e punës, sipas përcaktimit me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Neni 40

Neni 88 ndryshohet si më poshtë:

Neni 88  
**Të drejtat e fituara**

1. Sigurimi shoqëror është jofitimprurës. Me kontributet e derdhura garantohet pagesa në para për të kompensuar pakësimin e të ardhurave në një shumë që mbulon të paktën një standard minimal jetese, i cili përcaktohet nga Këshilli i Ministrave. Kur standardi minimal i jetesës nuk arrihet nga pensioni, për pensionistët me datë fillimi deri më 31.12.2014, Këshilli i Ministrave ka të drejtë të vendosë një shtesë të ardhurash në formë kompensimi të plotë.

2. Pensionet e caktuara në bazë të ligjit nr. 4171, datë 13.4.1966, “Për sigurimet shoqërore të Republikës Popullore të Shqipërisë”, quhen të mirëqena dhe nuk do të jenë objekt i ndonjë ndryshimi, me përjashtim të indeksimit dhe kompensimit, sipas pikës 1, të këtij neni.

3. Pensionet e caktuara në bazë të ligjit nr. 4976, datë 29.6.1972, “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore të Republikës Popullore të Shqipërisë”, me të gjitha ndryshimet e tij të mëvonshme, quhen të mirëqena dhe nuk janë objekt i ndonjë ndryshimi, me përjashtim të indeksimit dhe kompensimit, sipas pikës 1, të këtij neni.

4. Pensionet për personat që u lind e drejta deri më 31.12.2014, përfshirë edhe këtë datë, caktohen sipas dispozitave ligjore që kanë qenë në fuqi deri në atë datë dhe nuk janë objekt ndryshimi apo rilloaritjeje përveç indeksimit dhe kompensimit, sipas përcaktimeve me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Pensionet dhe përfitimet e tjera nga sigurimi shoqëror suplementar, të caktuara sipas dispozitave

ligjore që kanë qenë në fuqi deri më 31.12.2014, për kategoritë e përfshira në pikën 1, të nenit 4, të këtij ligji, nuk janë objekt i ndonjë ndryshimi, me përjashtim të indeksimit dhe kompensimit sipas përcaktimeve me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Personat, që marrin përfitime afatshkurtra për paaftësi, barrë lindje, sigurim papunësie etj., me datë fillimi përpara datës 31.12.2014, përfshirë edhe këtë datë, do ta përfitojnë atë në masën dhe kriteret e përcaktuara në dispozitat që kanë qenë në fuqi deri në atë datë.

7. Personat, të cilët deri në datën 31.12.2014, merrnin pension pleqërie, pension të parakohshëm, pension familjar, pension për vjetërsi shërbimi, pension për vjetërsi shërbimi në raste të veçanta, do të vazhdojnë të tërheqin pensionin e tyre. E njëjta gjë do të zbatohet edhe për shtesat e dhëna për pjesëmarrjen në luftën kundër pushtuesve nazifashistë.

8. Personat që deri në datën 31.12.2014 përfitojnë pension invaliditeti, do të vazhdojnë ta marrin atë me përjashtim të rastit kur, pas një rivlerësimi të gjendjes shëndetësore, ligji i ri rezulton me kushte më të favorshme.”

Neni 41

Në nenin 90, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Kontributi i të vetëpunësuarve në bujqësi do të rritet gradualisht deri në barazimin me kontributet e personave të vetëpunësuar në aktivitete jobujqësore në vitin 2018. Rritja vjetore e masës së kontributit caktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Neni 42

Në nenin 91, pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Periudha e kryerjes së studimeve në shkollën e lartë, me shkepëputje nga puna për gruan, duke filluar nga data 1.9.2000 dhe deri më 31.12.2032, pavarësisht nga vendi se ku janë kryer studimet dhe për jo më shumë se 6 vjet, njihet periudhë sigurimi vetëm për efekt pensioni pleqërie. Në kuptim të këtij neni, viti shkollor është me 12 muaj.

Në këtë rast, kontributet përballohen nga Buxheti i Shtetit, në kohën kur merret vendim për caktimin e pensionit.”

Neni 43

Neni 92 ndryshohet si më poshtë:



“Neni 92

Zgjatja graduale e moshës dhe periudhës së sigurimit për pension

1. Moshë dhe periudha e sigurimit për pension

pleqërie, deri në arritjen e moshës dhe plotësimin e periudhës së sigurimit, që përcaktohet në pikën 1, të nenit 31, të këtij ligji, do të rriten sipas tabelave që vijnë:

## MOSHA DHE PERIUDHA E SIGURIMIT QË KËRKOHET NË VITE PËR SECILËN KATEGORI

## BURRI

Vitet	Kategoria I		Kategoria II		Kategoria III	
	Mosha	Vjetërsia e punës	Mosha	Vjetërsia e punës	Mosha	Vjetërsia e punës
1993	50	20	55	25	60	25
1994	50	20	55	25	60	25
1995	51	21	56	26	60	26
1996	51	21	56	27	60	27
1997	52	22	57	28	60	28
1998	52	22	57	29	60	29
1999	53	23	58	30	60	30
2000	53	23	58	31	60	31
2001	54	24	59	32	60	32
01.07.2002 - 30.06.2003	54	24	59	33	60v 6m	33
01.07.2003 - 30.06.2004	55	25	60	34	61v	34
01.07.2004 - 30.06.2005	55	25	60v 6m	35	61v 6m	35
01.07.2005 - 30.06.2006	56	26	61v	35	62v	35
01.07.2006 - 30.06.2007	56	27	61v 6m	35	62v 6m	35
01.07.2007 - 30.06.2008	57	28	62v	35	63v	35
01.07.2008 - 30.06.2009	57	29	62v 6m	35	63v 6m	35
01.07.2009 - 30.06.2010	58	30	63v	35	64v	35
01.07.2010 - 30.06.2011	58	31	63v 6m	35	64v 6m	35
01.07.2011 - 30.06.2012	59	32	64v	35	65v	35
01.07.2012 - 30.06.2013	59	33	64v 6m	35	65v	35
01.07.2013 - 30.06.2014	60	34	65v	35	65v	35
01.07.2014 - 31.12.2014	60v 6m	35	65v	35v	65v	35
01.01.2015 - 31.12.2015	61v	35v 4m	65v	35v 4m	65v	35v 4m
01.01.2016 - 31.12.2016	61v 6m	35v 8m	65v	35v 8m	65v	35v 8m
01.01.2017 - 31.12.2017	62v	36v	65v	36v	65v	36v
01.01.2018 - 31.12.2018	62v 6m	36v 4m	65v	36v 4m	65v	36v 4m
01.01.2019 - 31.12.2019	63v	36v 8m	65v	36v 8m	65v	36v 8m
01.01.2020 - 31.12.2020	63v 6m	37v	65v	37v	65v	37v
01.01.2021 - 31.12.2021	64v	37v 4m	65v	37v 4m	65v	37v 4m
01.01.2022 - 31.12.2022	64v 6m	37v 8m	65v	37v 8m	65v	37v 8m
01.01.2023 - 31.12.2023	65v	38v	65v	38v	65v	38v



01.01.2024 - 31.12.2024	65v	38v 4m	65v	38v 4m	65v	38v 4m
01.01.2025 - 31.12.2025	65v	38v 8m	65v	38v 8m	65v	38v 8m
01.01.2026 - 31.12.2026	65v	39v	65v	39v	65v	39v
01.01.2027 - 31.12.2027	65v	39v 4m	65v	39v 4m	65v	39v 4m
01.01.2028 - 31.12.2028	65v	39v 8m	65v	39v 8m	65v	39v 8m
01.01.2029 - 31.12.2029	65v	40v	65v	40v	65v	40v
01.01.2030 - 31.12.2030	65v	40v	65v	40v	65v	40v
01.01.2031 - 31.12.2031	65v	40v	65v	40v	65v	40v
01.01.2032 - 31.12.2032	65v	40v	65v	40v	65v	40v
01.01.2033- 31.12.2033	65v 1m	40v	65v 1m	40v	65v 1m	40v
01.01.2034- 31.12.2034	65v 2m	40v	65v 2m	40v	65v 2m	40v
01.01.2035- 31.12.2035	65v 3m	40v	65v 3m	40v	65v 3m	40v
01.01.2036- 31.12.2036	65v 4m	40v	65v 4m	40v	65v 4m	40v
01.01.2037- 31.12.2037	65v 5m	40v	65v 5m	40v	65v 5m	40v
01.01.2038- 31.12.2038	65v 6m	40v	65v 6m	40v	65v 6m	40v
01.01.2039- 31.12.2039	65v 7m	40v	65v 7m	40v	65v 7m	40v
01.01.2040- 31.12.2040	65v 8m	40v	65v 8m	40v	65v 8m	40v
01.01.2041- 31.12.2041	65v 9m	40v	65v 9m	40v	65v 9m	40v
01.01.2042- 31.12.2042	65v10m	40v	65v10m	40v	65v10m	40v
01.01.2043- 31.12.2043	65v11m	40v	65v11m	40v	65v11m	40v
01.01.2044- 31.12.2044	66v	40v	66v	40v	66v	40v
01.01.2045- 31.12.2045	66v1m	40v	66v1m	40v	66v1m	40v
01.01.2046- 31.12.2046	66v 2m	40v	66v 2m	40v	66v 2m	40v
01.01.2047- 31.12.2047	66v 3m	40v	66v 3m	40v	66v 3m	40v
01.01.2048- 31.12.2048	66v 4m	40v	66v 4m	40v	66v 4m	40v
01.01.2049- 31.12.2049	66v 5m	40v	66v 5m	40v	66v 5m	40v
01.01.2050- 31.12.2050	66v 6m	40v	66v 6m	40v	66v 6m	40v
01.01.2051- 31.12.2051	66v 7m	40v	66v 7m	40v	66v 7m	40v
01.01.2052- 31.12.2052	66v 8m	40v	66v 8m	40v	66v 8m	40v
01.01.2053- 31.12.2053	66v 9m	40v	66v 9m	40v	66v 9m	40v
01.01.2054- 31.12.2054	66v10m	40v	66v10m	40v	66v10m	40v
01.01.2055- 31.12.2055	66v11m	40v	66v11m	40v	66v11m	40v
01.01.2056- 31.12.2056	67v	40v	67v	40v	67v	40v

MOSHA DHE PERIUDHA E SIGURIMIT QË KËRROHET NË VITE PËR SECILËN KATEGORI  
GRUAJA

Vitet	Kategoria I		Kategoria II		Kategoria III	
	Mosha	Vjetërsia e punës	Mosha	Vjetërsia e punës	Mosha	Vjetërsia e punës
1993	45	15	50	20	55	20
1994	45	15	50	21	55	21
1995	46	16	51	22	55	22



1996	46	17	51	23	55	23
1997	47	18	52	24	55	24
1998	47	19	52	25	55	25
1999	48	20	53	26	55	26
2000	48	21	53	28	55	28
2001	49	22	54	30	55	30
01.07.2002 - 30.06.2003	49	23	54	32	55v 6m	32
01.07.2003 - 30.06.2004	50	24	55	34	56v	34
01.07.2004 - 30.06.2005	50	25	55v 6m	35	56v 6m	35
01.07.2005 - 30.06.2006	51	26	56v	35	57v	35
01.07.2006 - 30.06.2007	51	27	56v 6m	35	57v 6m	35
01.07.2007 - 30.06.2008	52	28	57v	35	58v	35
01.07.2008 - 30.06.2009	52	29	57v 6m	35	58v 6m	35
01.07.2009 - 30.06.2010	53	30	58v	35	59v	35
01.07.2010 - 30.06.2011	53	31	58v 6m	35	59v 6m	35
01.07.2011 - 30.06.2012	54	32	59v	35	60v	35
01.07.2012 - 30.06.2013	54	33	59v 6m	35	60v	35
01.07.2013 - 30.06.2014	55	34	60v	35	60v	35
01.07.2014 - 31.12.2014	55v 6m	35	60v	35	60v	35
01.01.2015 - 31.12.2015	56v	35	60v 2m	35v4m	60v2m	35v4m
01.01.2016 - 31.12.2016	56v 6m	35	60v4m	35v8m	60v4m	35v8m
01.01.2017 - 30.12.2017	57v	35	60v6m	36v	60v6m	36v
01.07.2018 - 30.06.2018	57v 6m	35	60v8m	36v4m	60v8m	36v4m
01.01.2019 - 31.12.2019	58v	35	60v10m	36v8m	60v10m	36v8m
01.01.2020 - 31.12.2020	58v 6m	35	61v	37v	61v	37v
01.01.2021 - 31.12.2021	59v	35	61v2m	37v4m	61v2m	37v4m
01.01.2022 - 31.12.2022	59v 6m	35	61v4m	37v8m	61v4m	37v8m
01.01.2023 - 31.12.2023	60v	35	61v6m	38v	61v6m	38v
01.01.2024 - 31.12.2024	60v4m	35v6m	61v8m	38v4m	61v8m	38v4m
01.01.2025 - 31.12.2025	60v8m	36v	61v10m	38v8m	61v10m	38v8m
01.01.2026 - 31.12.2026	61v	36v6m	62v	39v	62v	39v
01.01.2027 - 31.12.2027	61v4m	37v	62v2m	39v4m	62v2m	39v4m
01.01.2028 - 31.12.2028	61v8m	37v6m	62v4m	39v8m	62v4m	39v8m
01.01.2029 - 31.12.2029	62v	38v	62v6m	40v	62v6m	40v
01.01.2030 - 31.12.2030	62v4m	38v6m	62v8m	40 v	62v8m	40v
01.01.2031 - 31.12.2031	62v8m	39v	62v10m	40v	62v10m	40v
01.01.2032 - 31.12.2032	63v	40v	63v	40v	63v	40v
01.01.2033- 31.12.2033	63v 2m	40v	63v 2m	40v	63v 2m	40v
01.01.2034- 31.12.2034	63v 4m	40v	63v 4m	40v	63v 4m	40v
01.01.2035- 31.12.2035	63v 6m	40v	63v 6m	40v	63v 6m	40v
01.01.2036- 31.12.2036	63v 8m	40v	63v 8m	40v	63v 8m	40v
01.01.2037- 31.12.2037	63v10m	40v	63v10m	40v	63v10m	40v



01.01.2038- 31.12.2038	64v	40v	64v	40v	64v	40v
01.01.2039- 31.12.2039	64v2m	40v	64v2m	40v	64v2m	40v
01.01.2040- 31.12.2040	64v4m	40v	64v4m	40v	64v4m	40v
01.01.2041- 31.12.2041	64v6m	40v	64v6m	40v	64v6m	40v
01.01.2042- 31.12.2042	64v8m	40v	64v8m	40v	64v8m	40v
01.01.2043- 31.12.2043	64v10m	40v	64v10m	40v	64v10m	40v
01.01.2044- 31.12.2044	65v	40v	65v	40v	65v	40v
01.01.2045- 31.12.2045	65v2m	40v	65v2m	40v	65v2m	40v
01.01.2046- 31.12.2046	65v4m	40v	65v4m	40v	65v4m	40v
01.01.2047- 31.12.2047	65v6m	40v	65v6m	40v	65v6m	40v
01.01.2048- 31.12.2048	65v8m	40v	65v8m	40v	65v8m	40v
01.01.2049- 31.12.2049	65v10m	40v	65v10m	40v	65v10m	40v
01.01.2050- 31.12.2050	66v	40v	66v	40v	66v	40v
01.01.2051- 31.12.2051	66v2m	40v	66v2m	40v	66v2m	40v
01.01.2052- 31.12.2052	66v4m	40v	66v4m	40v	66v4m	40v
01.01.2053- 31.12.2053	66v6m	40v	66v6m	40v	66v6m	40v
01.01.2054- 31.12.2054	66v8m	40v	66v8m	40v	66v8m	40v
01.01.2055- 31.12.2055	66v10m	40v	66v10m	40v	66v10m	40v
01.01.2056- 31.12.2056	67v	40v	67v	40v	67v	40v

2. I siguruari ka të drejtë të marrë pension pleqërie në kushtet e kategorisë së parë ose të dytë, pasi ka plotësuar në këtë kategori jo më pak se 3/4 e viteve të sigurimit. I siguruari që ka plotësuar vitet e sigurimit, sipas tabelës së mësipërme, nga të cilat jo më pak se 1/2 ka punuar në nëntokë, ka të drejtë të marrë pension në kushtet e kategorisë së parë.

#### Neni 44

Në nenin 93, shprehja “50 vjeç” zëvendësohet me shprehjen “55 vjeç”, ndërsa paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:

“Në rastet kur si vjetërsi pune, sipas kësaj tablele, kërkohet të njihet edhe vjetërsia si ish-anëtar i kooperativës bujqësore, dhe data e fillimit të pensionit është nga data 1.1.2015 e në vazhdim, masa e pensionit llogaritet sipas neneve 32 dhe 96, të këtij ligji.”

#### Neni 45

Në fund të nenit 95 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Për pensionet me datë fillimi nga 1.1.2015 e në vazhdim ky nen nuk zbatohet.”

#### Neni 46

Në nenin 96 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Paragrafi i tretë ndryshohet si më poshtë:

“Të vetëpunësuarve në bujqësi, që plotësojnë kushtet për pension, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, mund t’u njihen periudhat e së kaluarës, si periudha sigurimi kundrejt pagesës së kontributeve, sipas masës së kontributeve të përcaktuara për vitin kur kryhet pagesa, por jo për periudhat para datës 1.10.1993.”

2. Pas paragrafit të pestë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Për personat, të cilëve e drejta për përfitim u lind në datën 1.1.2015 e në vijim dhe kanë periudha sigurimi në ish-kooperativat bujqësore, si dhe periudha të tjera në marrëdhënie pune me shtetin, apo periudha sigurimi pas vitit 1994, për llogaritjen e pensioneve të pleqërisë do të zbatohen nenet 31, 32, 92 dhe 93, të këtij ligji, ndërsa për pensionet e invaliditetit dhe pensionet familjare do të zbatohen nenet 35, 36, 40 dhe 41, të këtij ligji.”

#### Neni 47

Në nenin 98, paragrafi i parë shfuqizohet.



Neni 48

Në nenin 99 shtohet një paragraf më këtë përmbajtje:

“Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda vitit 2014, të nxjerrë aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji.”.

Neni 49

Ky ligj hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1.1.2015.

**KRYETARI**  
**Ilir Meta**

Miratuar në datën 31.7.2014

**LIGJ**  
**Nr. 107/2014**

**PËR PLANIFIKIMIN DHE ZHVILLIMIN E**  
**TERRITORIT**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1  
**Qëllimi**

Ky ligj ka për qëllim:

a) të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, nëpërmjet përdorimit racional të tokës dhe të burimeve natyrore;

b) të vlerësojë potencialin aktual e perspektiv për zhvillimin e territorit në nivel kombëtar e vendor, në bazë të balancimit të burimeve natyrore, të nevojave ekonomike e njerëzore dhe interesave publikë e privatë, duke bashkërenduar punën për:

i) mbrojtjen e burimeve natyrore, si: toka, në veçanti toka bujqësore, ajri, uji, pyjet, flora, fauna, peizazhet;

ii) krijimin e garantimit të territoreve të ndërtueshme, të organizuara në mënyrë të harmonizuar e funksionale, duke i dhënë përparësi hapësirës publike, mundësisë së banimit për të gjitha shtresat ekonomike e sociale, krijimit të infrastrukturës fizike të përshtatshme për nxitjen e investimit në ushtrimin e veprimtarive ekonomike,

sociale e kulturore, lehtësimit të përdorimit të sigurt të shërbimeve e komoditeteve publike, të transportit, komunikimit dhe infrastrukturës, përfshirë territoret e përshtatura;

iii) nxitjen e jetës ekonomike, shoqërore e kulturore në nivel kombëtar e vendor;

iv) garantimin e burimeve të furnizimit të mjaftueshëm dhe veçanërisht atij jetësor;

v) garantimin e kushteve të sigurisë së jetës dhe të shëndetit publik, rendit publik dhe sigurisë kombëtare;

vi) nxitjen e zhvillimit të balancuar rajonal për të siguruar shpërndarje të qëndrueshme të popullsisë në vend në bazë të burimeve;

c) të nxitë veprimet e duhura për mbrojtjen, restaurimin dhe rritjen e cilësisë së trashëgimisë natyrore e kulturore dhe për ruajtjen e shumëllojshmërisë biologjike, zonave të mbrojtura, monumenteve të natyrës, zonave të ndjeshme mjedisore dhe të peizazhit;

ç) të mundësojë të drejtën e përdorimit e të zhvillimit të pronës, në përputhje me dokumentet planifikuese dhe sipas legjislacionit mjedisor në fuqi;

d) të krijojë kushte të përshtatshme e të drejta dhe shanse të barabarta për banim, veprimtari ekonomike e sociale për të gjitha kategoritë sociale, kohezion ekonomik e social dhe gëzim të të drejtave të pronësisë;

dh) të sigurojë që autoritetet kombëtare e vendore të planifikimit të hartojnë e të përditësojnë rregullisht dokumentet e planifikimit, sipas kërkesave të tregut dhe nevojave sociale;

e) të sigurojë që autoritetet e planifikimit të bashkërendojnë veprimtaritë e tyre planifikuese për të nxitur planifikimin e harmonizuar e të integruar të territorit;

Neni 2  
**Objekti**

Ky ligj ka për objekt përcaktimin e parimeve bazë, përgjegjësi dhe rregullave për planifikimin dhe zhvillimin e territorit në Republikën e Shqipërisë.

Neni 3  
**Përkufizime**

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Agiencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT)” është institucion me përgjegjësi planifikimi në kuadër të ministrisë përgjegjëse për çështjet e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

2. “Autoritetet e planifikimit” janë organet dhe institucionet publike, që kanë përgjegjësi për



planifikimin dhe zhvillimin e territorit, në përputhje me nenin 5 të këtij ligji.

3. “Autoritetet e inspektimit të ndërtimit” janë organet e përcaktuara në legjislacionin për inspektimin e ndërtimit.

4. “Bashkim për qëllim zhvillimi” është bashkimi i dy apo më shumë parcelave në një të vetme, për qëllime zhvillimi, në përputhje me përcaktimet e parashikuara në këtë ligj, në aktet nënligjore në zbatim të tij dhe në dokumentet e planifikimit.

5. “Baza e të dhënave shtetërore GIS” është përmbledhja e të gjitha dokumenteve të planifikimit të territorit, sipas përcaktimit të legjislacionit për të dhënat gjeohapësinore, në përputhje me parimet e GIS dhe në shtresa individuale të hartave të përgatitura me mjete digjitale.

6. “Certifikata e përdorimit” është dokument zyrtar i lëshuar nga autoriteti përgjegjës në miratim të kërkesës, i cili vërteton se ndërtimi është në përputhje me kushtet e lejes së ndërtimit dhe se punimet e kryera dhe ndërtimi janë të përshtatshme për përdorim.

7. “Çështje, zona dhe objekte të rëndësisë kombëtare në planifikimin e territorit” janë ato çështje, zona dhe objekte që njësohen ose lidhen me interesa shtetërore ose kombëtarë.

8. “Deklaratë paraprake për kryerje punimesh” është deklarata e depozituar pranë autoritetit përgjegjës të planifikimit për punime që nuk kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

9. “Dokumente të planifikimit” janë dokumente zyrtare të planifikimit që hartohen dhe zbatohen në territor, në nivel qendror dhe vendor, në përputhje me nenin 16 të këtij ligji.

10. “E drejta për zhvillim” është e drejta ligjore për të zhvilluar një parcelë dhe/ose një zonë, në përputhje me dokumentet e planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit. E drejta për zhvillim është e dallueshme nga e drejta e pronësisë dhe jepet nga autoriteti vendor i planifikimit, që ka kompetencën për të rregulluar përdorimin e tokës në juridiksionin e tij, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Të drejtat për zhvillim mund të mbahen nga pronari i tokës, të shkëmbehen ose të shiten.

11. “Infrastrukturë publike” është tërësia e rrjeteve, instalimeve dhe e ndërtimeve ekzistuese ose të parashikuara në territor, si dhe e hapësirave publike, që synojnë realizimin e shërbimeve publike në fushat e transportit, të energjisë, administrimit të ujit, komunikimit elektronik, arsimit, shëndetësisë,

administrimit të mbetjeve dhe mbrojtjes së mjedisit, administrimit të burimeve natyrore e kulturore, mbrojtjes kombëtare, civile e kundër zjarrit si dhe të tjera fusha të ngjashme në shërbim të publikut. Infrastruktura publike ka karakter kombëtar ose vendor dhe realizohet me investime publike ose private.

12. “Kërkesë për zhvillim” është kërkesa e paraqitur pranë autoritetit përgjegjës të planifikimit për lejimin e punimeve dhe ndërtimit, e cila përmban dokumentacionin e përcaktuar në këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

13. “Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT)” është organ kolegjal që funksionon pranë Këshillit të Ministrave dhe kryesohet nga Kryeministri.

14. “Kontroll i zhvillimit” është procesi, në bazë të të cilit autoriteti përgjegjës i planifikimit vlerëson dhe vendos nëse një kërkesë për zhvillim, kërkesë për ndërtim, kryerja e punimit ose ndërtimit përputhet me dokumentet e planifikimit, zhvillimit dhe të kontrollit të zhvillimit, të miratuara, kodin e ndërtimit dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi.

15. “Kushte zhvillimore” janë kushtet e përcaktuara nga plani i detajuar vendor ose, në mungesë, nga plani i përgjithshëm vendor dhe, në mungesë të të dyjave, të përcaktuara nga autoriteti përgjegjës i planifikimit që shërbejnë si bazë për hartimin e dokumentacionit të domosdoshëm për pajisjen me leje ndërtimi.

16. “Leje ndërtimi” është akti i miratimit të kërkesës për leje ndërtimi dhe i lejimit të punimeve përkatëse.

17. “Leje zhvillimi” është akti i përcaktimit të kushteve zhvillimore për një parcelë/pronë të caktuar, që shërben si bazë për pajisjen me leje ndërtimi.

18. “Miratim në heshtje” është akti i përfutimit të së drejtës për zhvillim, kryerje të punimeve apo përdorim të ndërtimit pa marrjen e miratimit nga autoriteti përgjegjës i planifikimit, nëse miratimi ose refuzimi i kërkesës nuk është dhënë brenda afatit të parashikuar nga dispozitat përkatëse të këtij ligji.

19. “Mjete tradicionale të informimit” janë:

a) regjistri elektronik;

b) posta elektronike;

